

SPECIFIKIMET TEKNIKE TE UNIFORMES SE F.S.P.D-së

1- Xhup dimëror me tre shtresa me kapuç:

Specifikimi Teknik i artikullit “Xhupa dimeror me tre shtresa me kapuç” (*treçereksh*) për Forcat e Sigurisë së APD paraqet kërkesat themelore teknike të domsdoshme. **Të gjitha përcaktimet teknike të këtij Specifikimi Teknik duhen të zbatohen detyrimisht saktë nga prodhuesi.** Treguesit fiziko-mekanik e kimik të lëndës së I-rë material Poliestër **BLU NAVY** treshtresor si dhe të materialeve të tjera ndihmëse që do të përdoren për konfeksionimin e artikullit “Xhup dimëror me tre shtresa me kapuç” (*treçereksh*) duhet të rezultojnë të jenë domosdosmerisht në përputhje me Specifikimet Teknike të mëposhtme. **Materialet** që duhet të përdoren për prodhimin e artikullit “Xhup dimëror me tre shtresa me kapuç” (*treçereksh*) janë:

Lenda e I-rë

Materia sintetik dy shtresor cilesia e I-rë me këto të dhëna:

Ngjyra	BLU NAVY
Përberja	100% Poliester
Thurja	garniture, 2/2 Z
Masa gr/m ²	230gr/m
Dendësia fije/10 cm	D baze 460 +/- 10 fije, D ind, 320 +/- 10 fije
Qendrueshmeria kG	B 700, I 840
Numri metrik	Nm baze 75/1, Nm ind 75/1
Trashësia e tekstili	0.2 - 0.3 mm
Qëndrueshmeria në fërkim	mbi 950 cikle, 1000 cikle
Qëndrueshmeria e ngjyrës	Nota 4-5
Abrasion	20.000 cikle

Qendrueshmeria e ngjyres (ne ferkim te thate e te njome, ne solucion djerse dhe sapun) e qendrueshme, shume e qendrueshme.

Materialet ndihmëse qe duhet te perdoren per ndertimin e artikullit “Xhup dimeror me tre shtresa me kapuç” jane :

Astar mendafshi importi 80-90gr/m² (me ngjyre te njejte ose te afert me materialin e siperm).

Astar xhepi tekstil 100% viskoz,

Frazeline, filter per pjesen e ngrohte,

Vatine me mase 130-170gr/m²

Penj qepje 100% polyester ne ngjyre te njejte ose te afert me stofin qe konfeksionohet, **Kanavace** importi,

Kopsa te medha ebaniti me ngjyre te njejte ose te afert ose butona mashkull-femer

Zinxhire te medhenj per bashkimin e dy perpareseve dhe veshjes se ngrohte me xhupin.

Zinxhire te vegjel per xhepat.

Ne lenden e pare nuk lejohen difekte te pamjes se jashtme, njolla te ndryshme, tonacione ngjyre, oksidime, rrudhosje, mungese ose trashim fijesh ne ind ose ne baze.

PERSHKRIMI:

Xhup dimëror me tre shtresa me kapuç, është i përbërë nga tre shtresa

- **Pjesa e jashteme** e ndertuar me material sintetik dy shtresor

- **Pjesa e brendshme** e ndertuar me astar mendafshi

Veshja e ngrohte perbehet nga filter me astar te dyfishte

Xhupi dimeror me tre shtresa me kapuç perbehet nga shpina, mënget, dorezat e mengeve, perpareset, bordure përpara, jaka, kapuçi .

Shpina është me supanje dhe me dy pala qe vijojne nga bashkimi i supanjes me shpinen deri tek gavatura e menges ne forme harkore.

Mënga është e përbërë nga dy pjesë, e sipërmja dhe e poshtmja si dhe dorezat e mëngeve. Dorëzat e mëngëve me gjerësi 4-5 cm mbyllet me anë të shiritit ngjitës ose me komce. Mëngës nga sipër i kalohen dy tegela. Në mëngën e majtë të xhupit, 12 cm poshtë qepjes së bashkimit të mëngës me trupin, e matur nga pika me e lartë e supit në qendër (kjo ulje do të vlejë për të gjithë numrat e gjokseve) qepet me tegela anësore dygjilperesh, materiali velkrof femer ngjyrë e errët për vendosjen e logos së krahut.

Perpareset në nivelin e gjoksit kanë dy xhepa (nga një për sejcilen anë) që mbyllet me zinxhir, mbi këto xhepa qepet me tegela anësore dygjilperesh, materiali velkrof femer ngjyrë e errët për vendosjen e logos së mbiemrit dhe logos së gjoksit, kurse në perparësën e djathtë, në pjesën e brendshme; në nivelin e poshtëm ka një xhep të vogël. Në të dy perparëset ka dy xhepa në formë katrore dhe me kapak, nga një për sejcilen anë, me fileto. Kapaket e xhepave me përmasa 7X20cm. Në të dyja pjesët e perparësës ku bashkohen me shpinën krijohet një hapje prej 20 cm me qëllim të përdorimit të armës dhe pajisjeve të tjera të shërbimit. Mbyllja e saj realizohet me anë të një patileti të sipër dhe perfundon me buton. Kapaket shërbejnë për të mbuluar zinxhirin. Tek kapaket vendosen butona që shërbejnë për t'u mberthyer, dy vendosen në jakë dhe këto vendosen në trup.


Jaka përbëhet nga dy pjesë me vatine brenda. Jaka është tip golf me madhësi në raport me numrin e xhupit. Tek jaka nga brenda vendoset një yll që shërben për të varur xhupin.

Spaletat duhet të jenë drejtkëndore në njërin anë dhe me kulm (me formë shigjete) në anën tjetër. Ana drejtkëndore duhet të qepet tek tegeli i rrethit të mëngës (gavatura). Katër brinjët e tjera përshkohen nga një tegel perimetral sipërfaqësor një gjilpërësh me distancë rreth 5 mm nga buza. Spaleta duhet të ndërtohet me dy shtresa tekstili ngjyrë blu (njësoj si xhupi) me përmasa të njëjta.

Shtresa e sipërme e spaletës duhet të përforcohet me frazelinë termoadezive. Përçina duhet të jetë në anën e "shigjetës", distancë rreth 1.5 cm nga kulmi.

Përçina duhet të qepet në të njëjtin pozicion tek supi i xhupit. Përçina duhet të jetë me diametër 17 mm, metalike, ngjyrë **Blu Navy**.

Gjatësia e spaletës duhet të ndryshojë në varësi të masës së xhupit. Gjatësia e spaletës duhet të rritet me 2-3 mm për çdo masë. Përmasat bazë duhet të jenë këto: 13.5 x 4.8 cm për masën më të vogël të xhakëtës dhe 18 x 4.8 cm për masën më të madhe të xhupit.



Pjesa e brendshme e ndërtuar me astar mendafshi; në të dy perparëset në këto pjesë në nivelin e gjoksit ka dy xhepa (nga një për sejcilen anë) që mbyllet me zinxhir, kurse në perparësën e djathtë, në pjesën e brendshme; në nivelin e poshtëm ka një xhep të vogël.

Veshja e ngrohte përbëhet nga filter me astar të dyfishtë me fileto në të gjitha anët.

Ne te gjithë perimetrin e saj (pervec pjeses se poshtme) ajo ka zinxhir qe ben bashkimin e saj me xhupin duke bere te mundur heqjen dhe venien e saj sipas deshires.

Ne secilen ane, ne pjesen e brendshme, ne nivelin e gjoksit veshja e ngrohte ka nga nje xhep qe mbyllet me zinxhir. Ne fund te xhupit dy anet te jene te cara ,model sallkie dhe mbyllja realizohet me kopsa.Kjo per veprime me te lehta operationale.

Kapuçi është me material te njejte si i xhupit. Në pjesën e brendshme vishet me me astar të hollë. Gjatë gjatësisë së kapuçit ka nje bordure me tegel te dyfishte e cila sherben per te futur kordon lidhes. Ky kordon del ne pjesen e brendshme te kapucit ne fund te bordures me dy sycka metalike duke krijuar mundesine e lidhjes dhe shtrengimit te kapucit.

APLIKIMI I ELEMENTËVE VELCRO

Xhup dimeror me tre shtresa me kapuç duhet të pajiset me 3 elementë Velcro femër:

1 copë për vendosjen e Logos së gjoksit.

1 copë për Logon e Mbiemrit , me përmasa 8.6 x 3 cm.

1 copë me formën e Logos se F.S.P.D-se në mëngën e majtë.

Elementët Velcro në gjoks duhet të vendosen paralel me njëra-tjetrën dhe të barazlanguara. Elementët *Velcro* duhet të qepen me tegel linear perimetral me ngjyrë blu dhe të përforcohen me dy tegela diagonalë. Qepja e elementëve *Velcro* duhet të bëhet me ndihmën e frazelinës në mënyrë që të mos ketë dëmtime ose grisje të tekstilit gjatë qepjes dhe gjatë përdorimit

AMBALLAZHIMI DHE ETIKETIMI

Çdo **Xhup dimeror me tre shtresa me kapuç** duhet të pajisen me etiketa prej tekstili, në të cilat duhet të shkruhet ky informacion: emri i fabrikës, viti i prodhimit, masa, përbërja dhe instruksionet e mirëmbajtjes. Tek xhupi duhet të qepet një etiketë tek xhepi i brendshëm i djathtë (i veshur). Në momentin e dorëzimit **Xhupi dimeror me tre shtresa me kapuç** duhet të jenë të pastër, të hekurosur, pa njolla dhe secili artikull duhet të paketohet në një qese polietileni. Xhupi duhet të futet në një qese tjetër polietileni. Në çdo kuti duhet të vendosen **Xhup dimeror me tre shtresa me kapuç** të së njëjtës masë dhe gjinie. Çdo kuti duhet të ketë sasi të barabartë artikujsh. Kartoni i kutive (me peshë rreth 600 gr/m²) duhet të jetë i përshtatshëm për transportin e sigurt të produkteve. Kutitë duhet të jenë të padëmtuara dhe të izoluara me shirit ngjitës (natriban) **dhe të personalizuar**.

MASAT DHE SASIA E PRODHIMIT

Artikulli **Xhup dimëror me tre shtresa me kapuç** do të porositet dhe do të prodhohet në masat XS – XXXL për femra dhe S – XXXL për meshkuj, dhe në sasi të që do të rezultojnë pas matjeve të punonjësve të *Punonjësve të Sigurisë Portit Durrës*.

Marrja e masave trupore

Marrja e masave trupore të mëposhtme është e nevojshme për nxjerrjen e përmasave të këtij artikulli:

Artikulli konsiderohet teknikisht i pranuar kur ai ploteson te gjitha kerkesat e ketij Specifikimi Teknik

Cope: 140 (njqind e dyzetë).

2-Kostum (Nje xhakete+dy pale pantallona+Nje kapele+Nje kapuç)

a) **Xhaketa:**

Parametrat fizike:

Materiali 65% poliester 35% pambuk. Pesha 245gr/m². Ngjyra **Blu Navy**

Masat disponibel: XS – XXXL për femra dhe S – XXXL për meshkuj. Jaka 8cm e larte gjysme golf me pjese mbyllese te qafes me material Velcof . Menget dhe pjesa e supeve qepur me dopjo tegel.

Te ketë 2 xhepa ne kraharor me permasa 14x15cm me mbyllje me kapake me dopjo tegel me permasa 14.5x5cm me precina **blu navy** metalike me diameter 10mm. Mbyllja ne anen e perparme me zinxhir me ngjyre **blu navy** me togez metalike. Zinxhiri mbuluar me nje bordure 40 mm te gjere. 2 precina Blu Navy metalike ne cdo skaj te bordures 2 cm nga lart dhe 2 cm nga poshte. 2 xhepa te pjerret nga nje ne secilen ane me mbyllje me precine metalike Blu Navy me diameter 10mm. Xhep ne Mengen e majte me permasa 10x10cm me mbyllje me kapak 10.5x5.5cm me dopjo tegel me mbyllje me precine metalike te zeze, pozicionuar 13 cm poshte tegelit te supit. Menget me bordure 38 mm me mbyllje **me velkro**.


Pjesa fundore e xhaketes te jete simetrike me permasat trupore e pershtatshme te futet ne pantallona dhe e pershtatshme per mbajtjen e pajisjeve personale te sherbimit.

Spaletat duhet të jenë drejtkëndore në një rën anë dhe me kulm (me formë shigjete) në anën tjetër. Ana drejtkëndore duhet të qepet tek tegeli i rrethit të mëngës (gavatura). Katër brinjët e tjera përshkohen nga një tegel perimetral sipërfaqësor një gjilpërësh me distancë rreth 5 mm nga buza. Spaleta duhet të ndërtohet me dy shtresa tekstili ngjyrë blu (njësoj si xhupi) me përmasa të njëjta.

Shtresa e sipërme e spaletës duhet të përforcohet me frazelinë termoadezive. Perçina duhet të jetë në anën e “shigjetës”, distancë rreth 1.5 cm nga kulmi.

Perçina duhet të qepet në të njëjtin pozicion tek supi i xhupit. Perçina duhet të jetë me diametër 17 mm, metalike, ngjyrë **Blu Navy**.

Gjatësia e spaletës duhet të ndryshojë në varësi të masës së xhupit. Gjatësia e spaletës duhet të rritet me 2-3 mm për çdo masë. Përmasat bazë duhet të jenë këto: 13.5 x 4.8 cm për masën më të vogël të xhaketes dhe 18 x 4.8 cm për masën më të madhe të xhupit .Për të vertetuar parametrat fizike do të analizohet mostra e dorëzuar.





APLIKIMI I ELEMENTËVE VELCRO

Xhaketa duhet të pajiset me 3 elementë Velcro femër:

1 copë për vendosjen e Logos së gjoksit.

1 copë për Logon e Mbiemrit , me përmasa 8.6 x 3 cm.

1 copë me përmasa 8 x 7 cm me formën e Logos se F.S.P.D-se në mëngën e majtë.

Elementët Velcro në gjoks duhet të vendosen paralel me njëra-tjetrën dhe të barazlanguara. Elementët *Velcro* duhet të qepen me tegel linear perimetral me ngjyrë blu dhe të përforcohen me dy tegela diagonalë. Qepja e elementëve *Velcro* duhet të bëhet me ndihmën e frazulinës në mënyrë që të mos ketë dëmtime ose grisje të tekstilit gjatë qepjes dhe gjatë përdorimit

b)Pantallonat:

Parametrat fizike:

Materiali 65% poliestër 35% pambuk. Pesha 245gr/m². Ngjyra Blu **Navy**. Me 2 xhepa vertikale te pjerret me dopjo tegel nga 1 ne secilen ane. Me 2 xhepa katror 17x15.5cm, 1 ne kofshen e majte dhe 1 ne te djathten qe mbyllen me kapak 16.5x5.5cm me dopjo tegel me kapje me Velcro. Te kete 2 xhepa me dopjo tegel dhe ne mes te kene nje bordure 4cm te gjere. Gjithashtu 2 xhepa ne pjesen e pasme me permasa 15x15cm me dopjo tegel. Me kapake me dopjo tegel me permasa 15.5x5.5cm. Edhe xhepat edhe kapaket ne 2 anet fundore vijne te prera me kend 45 grade. Qemeri 40cm i larte vjen me llastik ne te gjithe pjesen e pasme per veshje komforte. 6 ylyqe per vendosjen e rripit. Mbyllja perpara me zinxhir te zi me togez metalike dhe nje kopse Blu Navy siper tij. Per te vertetuar parametrat fizike do te analizohet mostra e dorezuar.



c) Ndërtimi i Kapeles

Parametrat fizike:

Kapela sportive duhet të jetë e tipit *baseball cap*, me mekanizëm plastik shtrëngues me kunj.

Pjesët përbërëse të saj janë:

1. Kupola
2. Streha
3. Mekanizëm plastik shtrëngues
4. Velcof për vendosjen e Logos në Kapele.



KUPOLA

Lartësia e kupolës duhet të jetë 17 cm. Ajo duhet të jetë e ndërtuar me pesë pjesë: katër pjesë trekëndore prej tekstili me përmasa të barabarta dhe pjesa ballore, e përforcuar me tekstil të kollarisur, që duhet të jetë sa dy pjesë të bashkuara.

Pjesët duhet të qepen me njëra-tjetrën me anë të tegelave linearë një gjilpërësh, ndërsa tek pjesa e ballore qepja duhet të bëhet vetëm tek buzët e lira, duke formuar kështu një pencë me gjatësi rreth 8 cm.

Tegeli i pencës duhet të jetë sipërfaqësor. Të gjitha prerjet e kupolës, përfshirë dhe pencën e pjesës ballore, duhet të përshkohen nga një tegel zbukurues një gjilpërësh me largësi 2 mm. Në anën e brendshme, tegelat qepës duhet të mbulohen me shirita termosaldues.

Astari i kapelës duhet të jetë i ndërtuar njësoj si kupola. Pjesët duhet të qepen me njëra-tjetrën me anë të tegelit syzator pesë fijesh (një tegel linear dhe një tegel mbulues).

Në pikën kulmore të kupolës, atje ku puthiten këndet e të gjitha pjesëve, duhet të qepet një kopsë e veshur me të njëjtin tekstil si kapela. Astari i kapelës kapet me tekstilin e jashtëm tek kopsa. Kapela duhet të pajiset në pjesën e pasme me mekanizëm plastik shtrëngues me kunjë. Tek buza e poshtme perimetrale e kupolës duhet të qepet një shirit përforcues plastik me ngjyrë të errët dhe gjerësi 5 mm që ka si funksion ruajtjen e formës së kapelës. Po tek i njëjti vend duhet të qepet edhe një shirit prej tekstili me gjerësi 3 cm. Shiriti duhet të qepet tek buza e poshtme, ndërsa buza e sipërme duhet të jetë e lirë. Shiriti duhet të jetë i përbërë nga një shtresë tekstili i prerë me kënd 45° dhe një shtresë sfungjer dhe frazelinë të ngjitura bashkë.




STREHA E KAPELES

Streha duhet të ketë përmasa 18 x 7 cm. Ajo duhet të jetë e përbërë nga një shtresë e harkuar plastike me ngjyrë të zezë dhe trashësi 2 mm e veshur me dy shtresa tekstili të njëjtë me kapelën. Shtresa plastike duhet të jetë relativisht e fortë dhe elastike.

Shtresat prej tekstili duhet të qepen me shtresën plastike nëpërmjet 4 ose më shumë tegelave lineare një gjilpërësh sipërfaqësorë me distancë 5 mm nga njëri - tjetri dhe distancë rreth 15 mm nga buza e lirë e strehës.

Streha duhet të qepet tek perimetri kupolës.



d) Kapuç Sherbimi

Ndërtimi i Kapuçit

Parametrat fizike:

Kapuçi prej leshi ngjyrë Blu Navy duhet prodhuar me formë tubolare. Trikotazhi i kapuçit duhet të ketë elasticitet të lartë.

Pjesët përbërëse të kapuçit:

- Tekstili i trikotuar
- Mbishkrimi **F.S.P.D**

Kapuçi duhet të prodhohet me makineri trikotazhi tubolare, me thurje llastik 1:1, i punuar me fill akriliku të përzier me lesh. Kapuçi duhet të mbyllet në pjesën e sipërme me 6 qepje; dy përpara, dy mbrapa dhe dy tegela anësorë. Filli i përdorur duhet të jetë i përshtatshëm për qëpjen e tekstilit të trikotuar. Akronimi “**F.S.P.D**” duhet të qëndiset tek bordura e palosur, në ballë të kapuçit. Qëndisja duhet të bëhet me ndihmën e frazelinës së përshtatshme për qëndisje në tekstil të trikotuar. Frazelina duhet të ketë të njëjtat përmasa si qëndisja. Akronimi “**F.S.P.D**” duhet Gjerësi 12 cm, Lartësi 3 cm, Lloji i germës Myriad Pro Bold, Ngjyra e bardhë, Përmasa reference Gjerësia 19.5 cm, Palosja 7 cm, Gjatësia 20 cm.

KUSHTE TË DOMOSDOSHME

Produkti përfundimtar duhet të jetë i njëjtë me kampionin e aprovuar gjatë procedurave të vlerësimit. Filli qepës duhet të ketë ekzaktësisht karakteristikat e përcaktuara në këtë specifikim teknik. Tegelat duhet të jenë të drejtë, uniformë, elastikë dhe nuk duhet të kenë shqepje ose defekte. Tegelat duhet të jenë të fortë dhe nuk duhet të shqepen nëse tërhiqen me duar. Tegelat duhet të jenë të përforcuar në ekstremitete. Të gjithë elementët e kapuçit duhet të jenë simetrik. Përpara se të fillojë prodhimi i artikullit, prodhuesi duhet të bëjë testimin e stabilitetit dimensional (aftësinë e tekstileve për të ruajtur formën pas lëshimit nga makina e trikotazhit, qepjes, larjes, hekurosjes, etj.). Në varësi të llojit, tekstili i trikotuar nuk duhet të lahet ose hekuroset në temperatura që kalojnë kufijtë e specifikuar nga prodhuesi në skedën teknike sipas EN ISO 3758 ose që janë specifikuar në këtë dokument. Gjithashtu tekstili i trikotuar nuk duhet të pësojë shkëlqim gjatë hekurosjes.

- Tekstili duhet të ketë rezistencë të lartë ndaj rrezatimit Ultraviolet.
- Tekstili duhet të ketë rezistencë maksimale ndaj përdorimit dhe konsumit.
- Kufiri i lejuar i gabimit tek përmasat e produktit është $\pm 2\%$.
- Tekstilet, materialet dhe aksesorët e përdorur në prodhimin e këtij artikulli nuk duhet të përmbajnë substanca të dëmshme për shëndetin e njeriut apo AZO ngjyrues.

Për produktin e gatshëm duhet të paraqiten rezultatet e këtyre testeve sipas standardeve:

a. EN ISO 14362-1:2017

b. EN ISO 14362-3:2017

c. EN ISO 3071:2006 (vlera limit e pH për veshjet që kanë kontakt direkt me lëkurën është 4.0 - 7.5 dhe për veshjet që nuk kanë kontakt direkt me lëkurën është 4.0 - 9.0).

- Prodhuksi i artikullit të mësipërm duhet të jetë i pajisur me çertifikatën e standardit ISO 9001.

Kapuçi duhet të pajiset me një etiketë prej tekstili, në të cilat duhet të shkruhet ky informacion: emri i fabrikës, viti i prodhimit, lloji i artikullit, përbërja, dhe instruksionet e mirëmbajtjes. Etiketa duhet të vendoset në tegelin qepës të mbylljes së kapuçit. Në momentin e dorëzimit kapuçi duhet të jetë i pastër dhe i rregullt. Ai duhet paketohet në një qese polietileni. Artikulli i paketuar duhet të vendoset në kuti kartoni. Kartoni i kutive (me peshë rreth 600 gr/m²) duhet të jetë i përshtatshëm për transportin e sigurt të produkteve. Çdo kuti duhet të jetë e pajisur me një etiketë me adeziv, në të cilën duhet shënuar masa, viti i prodhimit, sasia dhe emri i fabrikës prodhuese. Kutitë duhet të jenë të padëmtuara dhe të izoluara me shirit ngjitës (natriban).



Amballazhimi dhe Etiketimi

Të gjithë artikujt e kostumit (Nje xhakete+dy pale pantallona+Nje kapele+Nje kapuç) duhet të pajisen me etiketa prej tekstili, në të cilat duhet të shkruhet ky informacion: emri i fabrikës, viti i prodhimit, masa, përbërja dhe instruksionet e mirëmbajtjes. Tek **xhaketa** duhet të qepet një etiketë tek xhepi i brendshëm i djathtë (i veshur). Xhaketa duhet të ketë një perçinë rezervë, e cila duhet të vendoset në një qese plastike prej polietileni ose prej kartoni të hollë, të mbyllur mirë. Perçina rezervë duhet të jenë të pranishme tek secila xhakete. Ajo duhet të vendoset gjatë paketimit e kapur në etiketën e xhaketes me një fije plastike të siguruar mirë. Tek pantallonat duhet të qepet një etiketë në qendër të qemerit, mbrapa (në brendësi). Në momentin e dorëzimit kostumet duhet të jenë të pastër, të hekurosuar, pa njolla dhe secili artikull duhet të paktohet në një qese polietileni. Xhaketa dhe pantallonat duhet të futen bashkë në një qese tjetër polietileni. Në çdo kuti duhet të vendosen kostume të së njëjtës masë dhe gjinie. Çdo kuti duhet të ketë sasi të barabartë artikujsh. Kartoni i kutive (me peshë rreth 600 gr/m²) duhet të jetë i përshtatshëm për transportin e sigurt të produkteve. Çdo kuti duhet të jetë e pajisur me një etiketë me adeziv, në të cilën duhet shënuar masa e kostumit, gjinia, viti i prodhimit, sasia dhe emri i fabrikës prodhuese. Kutitë duhet të jenë të padëmtuara dhe të izoluara me shirit ngjitës (natriban).

MASAT DHE SASIA E PRODHIMIT

Artikulli Kostum (Nje xhakete+dy pale pantallona+Nje kapele+Nje kapuç)do të porositet dhe do të prodhohet në masat XS – XXXL për femra dhe S – XXXL për meshkuj, dhe në sasi të që do të rezultojnë pas matjeve të punonjësve të Punonjesve të Sigurisë Portit Durrës.

Marrja e masave trupore

Marrja e masave trupore të mëposhtme është e nevojshme për nxjerrjen e përmasave të këtij artikulli:

Artikulli konsiderohet teknikisht i pranuar kur ai plotëson të gjitha kërkesat e këtij Specifikimi Teknik

Cope: 140 (njqind e dyzetë) palë.

3-Bluzë me mëngë të gjata



Parametrat fizike:

Bluzat prodhohen me material 100% polyester fleece me mëngë të gjata për femra dhe për meshkuj janë njësoj në tekstil dhe ngjyrë **Blu Navy**.

Pjesët përbërëse të bluzës:

- Jaka gjysmë golf me zinxhir.
- Pjesa përpara
- Pjesa prapa (shpina)
- Dy mëngë të gjata

JAKA

Jaka duhet gjysme golf me zinxhir me gjatesi 20 cm dhe të ndërtohet me tekstil të njejtë me materialin baze dhe duhet të ketë lartësi standarde 3 cm. Bashkimi me dy pjesët e bluzës duhet të bëhet me anë të një një filetoje me gjerësi rreth 1cm. Qepja e filetos tek jaka dhe tek bluza duhet të bëhet me një tegel linear dy gjilpërësh.

PJESËT PËRPARA DHE MBRAPA

Pjesa para dhe ajo e pasme duhet të bashkohen me njëra-tjetrën me tegel syzator 5 fijesh. Në linjën e shpatullave duhet qepur një fileto përforcuese për ruajtjen e formës së supeve. Tek pjesa e shpatullave të bluzës së meshkujve dhe të femrave, në brendësi, duhet të qepet një shtresë në formën e gjysme rrethit prej të njëjtit tekstil si bluza. Rrezja e rrethit duhet të jetë rreth 7-9 cm. Përmasa e saktë e rrethit duhet të variojë sipas masës së bluzës.

Në fund bluza duhet të mbyllet me një palosje me lartësi rreth 2 cm nga buza fundore. Palosja duhet të qepet me tegel linear dy gjilpërësh i përforcuar nga brenda me tegel syzator. Fundi i bluzës duhet të jetë i drejtë dhe duhet të ketë të njëjtën gjatësi si para ashtu edhe mbrapa.

MËNGËT

Mënga përbëhet nga një pjesë e vetme tekstili. Përmasat e mëngës duhet të ndryshojnë në varësi të masës së bluzës. Mënga duhet të bashkohet me trupin e bluzës me 2 tegela: 1 tegel qepës linear dhe 1 tegel syzator 5 gjilpërësh. Mënga duhet të mbyllet me një

palosje me lartësi rreth 2 cm.Palosja duhet të jetë 2 cm dhe duhet të qepet me tegel syzator 5 fijesh (dy tegela linear dhe nje syzator).

APLIKIMI I ELEMENTËVE VELCRO

Bluza **me mëngë të gjata** duhet të pajiset me 3 elementë Velcro femër:

1 copë për vendosjen e Logos së gjoksit.

1 copë për Logon e Mbiemrit , me përmasa 8.6 x 3 cm.

1 copë me përmasa 8 x 7 cm me formën e Logos se F.S.P.D-se në mëngën e majtë.

Elementët Velcro në gjoks duhet të vendosen paralel me njëra-tjetrën dhe të barazlanguara. Elementi Velcro për vendosjen e shenjave në mëngë duhet të ketë një distancë rreth 6 cm nga gavatura e mëngës. Elementët *Velcro* duhet të qepen me tegel linear perimetral me ngjyrë blu dhe të përforcohen me dy tegela diagonale. Qepja e elementëve *Velcro* duhet të bëhet me ndihmën e frazulinës në mënyrë që të mos ketë dëmtime ose grisje të tekstilit gjatë qepjes dhe gjatë përdorimit.

Produkti përfundimtar duhet të jetë identik me kampionin e aprovuar gjatë procedurave të vlerësimit.Filli qepës duhet të ketë ekzakt karakteristikat e përcaktuara tek Specifikimet Teknike.Tegelat e qepjes së bluzës duhet të jenë me hap 30 shpime në 5 cm.Tegelat duhet të jenë të drejtë, uniformë, simetrik, me elasticitetin e duhur dhe nuk duhet të kenë shqepje ose defekte.Tegelat duhet të jenë të fortë dhe nuk duhet të shqepen nëse tërhiqen me duar. Fortësia e tegelave duhet të jetë mbi 12N.Tegelat duhet të jenë të përforcuar në ekstremitete.Të gjithë elementët e bluzës duhet të jenë simetrik.Përpara se të fillojë prodhimi i artikujve, prodhuesi duhet të bëjë testimin e stabilitetit dimensional (aftësinë e tekstilit për të ruajtur formën fillestare pas prerjes, qepjes, larjes, hekurosjes, etj.)Në varësi të llojit, tekstilet nuk duhet të lahen ose hekurosen në temperatura që kalojnë kufijtë e specifikuar nga prodhuesi në skedën teknike sipas EN ISO 3758 ose që janë specifikuar në këtë dokument. Gjithashtu tekstili nuk duhet të fitojë shkëlqim gjatë hekurosjes.Tekstili duhet të ketë rezistencë të lartë ndaj rrezatimit Ultraviolet.Tekstili duhet të ketë rezistencë maksimale ndaj përdorimit dhe konsumit.Kufiri i lejuar i gabimit tek përmasat e bluzave është $\pm 2\%$.Elementëve Velcro nuk duhet t'u dalin fijet anësore gjatë përdorimit të shpeshtë.Tekstilet, materialet dhe aksesorët e përdorur në prodhimin e këtij artikulli nuk duhet të përmbajnë substanca të dëmshme për shëndetin e njeriut apo AZO ngjyrues.

AMBALAZHIMI DHE ETIKETIMI

Bluza **me mëngë të gjata** duhet të pajiset me 1 etiketë prej tekstili, në të cilën duhet të shkruhet emri i fabrikës, viti i prodhimit, përmasa, përbërja, dhe instruksionet e mirëmbajtjes. Kjo etiketë duhet të qepet në brendësi të bluzës, në anën e majtë, rreth 12 cm nga buza e poshtme e bluzës.Bluza duhet të paloset duke vendosur të dy mëngët në brendësi.Bluza e palosur duhet të vendoset në një qese polietileni. Në çdo kuti duhet të vendosen bluza të një numri dhe gjinie. Çdo kuti duhet të ketë sasi të barabartë bluzash.Kartoni i kutive (me peshë rreth 600 gr/m²) duhet të jetë i përshtatshëm për transportin e sigurt të produkteve. Çdo kuti duhet të jetë e pajisur me një etiketë me adeziv, në të cilën duhet shënuar masa e bluzës, viti i prodhimit, sasia dhe emri i fabrikës prodhuese. Kutitë duhet të jenë të padëmtuara dhe të izoluar me shirit ngjitës (natriban).

MASAT DHE SASIA E PRODHIMIT

Artikulli **Bluzë me mëngë të gjata** do të porositet dhe do të prodhohet në masat XS – XXXL për femra dhe S – XXXL për meshkuj, dhe në sasi të që do të rezultojnë pas matjeve të punonjësve të *Punonjesve të Sigurisë Portit Durrës*.

Marrja e masave trupore

Marrja e masave trupore të mëposhtme është e nevojshme për nxjerrjen e përmasave të këtij artikulli:

Artikulli konsiderohet teknikisht i pranuar kur ai plotëson të gjitha kërkesat e këtij Specifikimi Teknik

Cope: 420(katërqind e njëzet) cope.

4-Pulovër e trashë me zinxhir:

Parametrat fizike:

Pulovra me zinxhir.

Keto specifikime teknike përcaktojnë kërkesat çilesore të prodhimit të pulovres me zinxhir të Forcës së Sigurisë. Të realizohet në linjë industriale në mbështetje të pamjes së jashtme të mostres fizike (një pulover nr. gjoksi 54/4, gjatesi trupore 173-178), të ndërtuar me materialet e poshtshenuara. Mostra e sjelle nga prodhuesi e të vlersuar nga perdoruesi (porositësi), të depozituar sipas përcaktimeve, do të shërbejë si baze për prodhim. Materialet që do të përdoren për prodhimin e pulovres me zinxhir përgjate gjithë pjesë së përparme të pulovres dhe me jakë gjysem golf: Zinxhiri duhet të ketë ngjyrën e vet Pulovrës me zinxhir (**Blu Navy**).

- Fill termik, çilesi e pare, me përberje poliestër fleece.

- Pësha = 300 ± 10 gr.

- Ngjyre **blu navy**.

- Punim i thjeshtë.

- Numri i fillit 40/2 - 42/2.

- Dok terikoton blu me përzierje pambuk e poliestër për performancën e supeve e të bryllave.

Frazeline (fortese) për performancën e spaletës.

APLIKIMI I ELEMENTËVE VELCRO

Pulover me zinxhir duhet të pajiset me 3 elementë Velcro femër:

1 copë për vendosjen e Logos së gjoksit.

1 copë për Logon e Mbiemrit, me përmasa 8.6 x 3 cm.

1 copë me përmasa 8 x 7 cm me formën e Logos së F.S.P.D-se në mëngën e majtë.

Elementët Velcro në gjoks duhet të vendosen paralel me njëra-tjetrën dhe të barazlanguara. Elementi Velcro për vendosjen e shenjave në mëngë duhet të ketë një distancë rreth 6 cm nga gavatúra e mëngës. Elementët *Velcro* duhet të qepen me tegel linear perimetral me ngjyrë blu dhe të përforcohen me dy tegela diagonale. Qepja e elementëve *Velcro* duhet të bëhet me ndihmën e frazelinës në mënyrë që të mos ketë dëmtime ose grisje të tekstilit gjatë qepjes dhe gjatë përdorimit. Vlerat e qendrueshmerisë së ngjyrave të lëndës së pare (fill blu navy), të jenë të qendrueshme e shumë të qendrueshme (nota 4 - 5). Ngjyra e mostres që do të nënshtruhet provës në qendrueshmeri të ndryshme (si ndaj ferkimit të thatë, të njome, në larje solucioni, sapun e djerse, etj.) nuk duhet të ndryshojë nga ajo e depozituar.

Jaka në formë gjysmë golf.

Mbyllja e mëngeve dhe e fundit të trupit me *Velcro*.

Në krahun e majtë, vendoset velkrof me formën femer me formën e Logos në Krahe.

Spaletat, dok i plastifikuar me gjerësi 45 m/m dhe gjatesi sipas numrave, që mberthehen me kopsa të vogla plastike, në ngjyrë Blu Navy.

Në lenden e pare (fill blu) çilesia e pare që do të përdoret për prodhimin e pulovrave me zinxhir të Forcës së Sigurisë, konsiderohen defekte të pamjes së jashtme dhe nuk lejohen: papastërti me orgjine bimore, njolla të ndryshme, sperkatje me vajra ose bojra, nuanca të ngjyrës, oksidime, rrudhosje, mungesë fije në baze e ind apo trashim i tyre, luhatje në gjerësi etj.

MASAT DHE SASIA E PRODHIMIT

Artikulli **Pulovër me zinxhir** do të porositet dhe do të prodhohet në masat XS – XXXL për femra dhe S – XXXL për meshkuj, dhe në sasi të që do të rezultojnë pas matjeve të punonjësve të *Punonjesve të Sigurisë Portit Durrës*.

Marrja e masave trupore

Marrja e masave trupore të mëposhtme është e nevojshme për nxjerrjen e përmasave të këtij artikulli:

Artikulli konsiderohet teknikisht i pranuar kur ai plotëson të gjitha kërkesat e këtij Specifikimi Teknik

Cope: 140 (njqind e dyzetë) Copë.

5-Këpuçë Dimërore

Parametrat fizike

Lekure natyrale boks vici dhe astar meshini vici.

Kepucet prodhohen sipas modelit klasik me ngjyre të zeze, ku maja është në formë U-je. Pjesa e poshtme, sholla është me material gome me llokma të dhembzuara, me trashësi 7-8mm pa llokma dhe 15-16 mm me llokma. Pjesa e sipërme ka trashësi 25-27mm pa fjalën dhe xhiron e gomes. Lekura e faqes, sipas të dhenave të mesiperme. Mbrapshtinat (veshet) në pjesën e sipërme të tyre kanë lekure të bute sheviro, brenda se cilës është vendosur një masë sfungjer, me qëllim që buzët e sipërme të jenë sa më të buta për një komoditet sa më të mirë. Veshja e brendshme me material GORE-TEX® me performancë të lartë 100% i papërkrahshëm nga uji dhe me ajrosje shumë të mirë dhe shtrroje lekure. Kepucet të jenë 6 vrima në secilën anë për kalimin e lidhësive. Lidhësat të jenë të zeza dhe të rrumbullakta, ose në formë kordoni me fije sintetike deri në 600mm. Në lekuren natyrale boks vici cil. I-re përfshihen lekuret e vicit që kanë sipërfaqe të shfrytëzueshme jo më pak se **96 %** dhe lejohen të kenë **4 %** të sipërfaqes me defekte ku **2 %** në kupon. Lekuret duhet të jenë të shtrira mirë, të buta, të ngjeshura dhe kompakte. Nga ana e brendshme të jenë të pastruara, të zmeriluara dhe të barazuara. Ngjyrimi të jetë i njellojtë në të gjithë sipërfaqen dhe pa tonacione.

Lartësia e qafes së kepuces (duke ju referuar numrit 41) nga jashtë e matur mbi xhiron e gomes të jetë 130 +/- 10 mm. Realizimi i bashkimit të pjesës së poshtme me pjesën e sipërme të kepuces realizohet nepermjet teknologjisë me injeksion të drejtperdrejte. Qepja e forcuar e shollës me pjesë të sipërme me tegel të fortë ngjyre të zeze. Pjesa e thembres me lekure të forcuar qepur me dopjo tegel. Pjesët anësore gjithasthu të qepura me dopjo tegel në të gjithë perimetrin. Në pjesën e sipërme të ketë një shirit kamoshi të butë për veshje komferte me lartësi 7-9mm. Në pjesën e pasme kjo pjesë kamoshi vjen e ngritur deri në 35mm.

bombe termoplastike me trashësi 1.4 +/- 0.1 mm.

forte termoplastike me trashësi 1.5 +/- 0.1 mm.

fiap gome e presuar me fortësi 85 +/- 3 grade shore (sipas STASH 2896-87) me trashësi 4-4.2 mm. xhiro gome e presuar me fiapen me pjerësi konike, trashësi 2.8-3 mm dhe gjerësi 17-19 mm. sholle gome e presuar TIP U me fortësi 75 +/- 3 grade shore (sipas STASH 2638 - 87) të presuar, nga poshtë duhet të jetë me llokma të dhembzuara, me trashësi 7-8 mm pa llokma, ndërsa me llokma trashësia duhet të jetë 13-14 mm. taka duhet të jetë e presuar së bashku me shollën me trashësi 25-26 mm. Bashkimi i pjesës së sipërme të kepuces me pjesën e gomuar duhet të realizohet me injeksion.

pë sintetik me ngjyre të zeze për qepje të lekures 100 % sintetik dhe qëndrueshmëri mbi 9 kg, për masurin Nm 40/3 dhe gjilperen Nm 30/3.

pë sintetik i thurur 1 mm për qepje 100 % PES dhe rezistencë 38 kG (1000 g).

taban soletit lekure me trashësi 3-3.5 mm. lidhëse të zeza të rrumbullakta thurje gershet deri në 60 cm gjatësi.

- a. Të jenë kundra rrëshqitjes.
- b. Të krijojnë lehtësi në mbathjen e z bathjen e tyre.
- c. Lëkura të jetë “ëaterproof”, e cilësisë së parë dhe higjienike.
- d. Të jenë rezistente në shqitje të gomës.
- e. Të jenë rezistente ndaj plasjes së faqes dhe në këputje të saj.
- f. Pjesa e brendshme të mos lëshojë bojë.

Ngjyra e zezë.

Raporti midis gjatesise dhe gjeresise ne varesi te numrit te kepuceve te plotesoje kushtet e standartit shqiptar.Per te vertetuar parametrat fizike do te analizohet mostra e dorezuar. **Artikulli konsiderohet teknikisht i pranuar kur ai ploteson te gjitha kerkesat e ketij Specifikimi Teknik**

Cope: 140 (njqind e dyzetë) Palë.



6-Çorape

Parametrat fizike

Çorape për uniformën e punës dimërore për meshkuj e femra të Forcës së Sigurisë Portit Durrës:

Modeli i çorapeve të jetë i njëjtë për të gjithë efektivin e Forcave të Sigurisë Portit Durrës.Përbërja të jetë 45% lesh, 45 % akrilik, 9 % poliamit,1 % llastik, të bëjë të mundur përthithjen e djersës gjatë përdorimit të mos pushëzohen.Filli i bazës dhe në ind të jetë i qëndrueshëm në këputje.Të ketë qëndrueshmëri të ngjyrës ndaj larjes, djersës, fërkimit, etj.Ngjyra e zezë. Masat që duhet te jene disponibile jane 37,38,39, 41, 43,45,49 sipas permasave te marra gjate matjeve.Për të vertetuar parametrat fizike do te analizohet mostra e dorezuar.Corapet e burrave duhet te jene te certifikuara sipas standardit nderkombetar OKEOTEX Standard 100

Artikulli konsiderohet teknikisht i pranuar kur ai ploteson te gjitha kerkesat e ketij Specifikimi Teknik

Cope: 420 (katerqind e njezet) Palë.



7-Xhup Veror


Parametrat fizike

Ngjyre e Blu Navy. Shtresa e jashtme 100% polyester me veshje PVC. Shtresa e brendshme astar në formë rrjete Xhupi i veror është i drejte dhe perbehet nga, dy pjeset para, shpina, menget dhe jaka. Në të dy pjeset e perparme poshte ka nga një xhëp të sipërm i cili qepet me një tegel dhe mbyllet me kapak me buton. Shpina është një copshe dhe në të vendoset shkrimi FSPD, 11 cm nga bashkimi i shpines me jakën.

Menget janë një copshe dhe bashkohen me shpinën dhe pjesët para me nga një tegel.

Jaka e lartë 75mm në formë gjysme golf dhe me mbyllje Velcro në ngjyrën e xhupit. Kapucë që futet brenda jakës dhe mbyllet me velcro. Kapucë me veshje të brendshme me të njëjtin material si veshja e brendshme e xhupit. Për mbyllje shërben një litar Blu Navy me llastik brenda me kapse të zeza plastike në çdo anë. Vendosen tre verkof me permasat e logove për ngjitjen e logove të mbiemrit, logos së krahut dhe logos në gjoks.

Spaletat:



formë shigjete) në

anën tjetër. Ana drejtkëndore duhet të qepet tek tegeli i rrethit të mëngës (gavatura). Katër brinjët e tjera përshkohen nga një tegel perimetral sipërfaqësor një gjilpërësh me distancë rreth 5 mm nga buza. Spaleta duhet të ndërtohet me dy shtresa tekstili ngjyrë blu navy (njësoj si xhupi) me përmasa të njëjta.

Shtresa e sipërme e spaletës duhet të përforcohet me frazelinë termoadezive. Perçina duhet të jetë në anën e “shigjetës”, distancë rreth 1.5 cm nga kulmi.

Perçina duhet të qepet në të njëjtin pozicion tek supi i xhupit. Perçina duhet të jetë me diametër 17 mm, metalike, ngjyrë blu navy.

Gjatësia e spaletës duhet të ndryshojë në varësi të masës së xhupit. Gjatësia e spaletës duhet të rritet me 2-3 mm për çdo masë. Përmasat bazë duhet të jenë këto: 13.5 x 4.8 cm për masën më të vogël të Xhupit veror dhe 18 x 4.8 cm për masën më të madhe të xhupit veror .

Xhupi veror mbyllet në anën e perparme me zinxhir dhe perçina , të dyja në ngjyrën e xhupit. Zinxhiri mbulohet nga një bordurë 6cm me dopjo tegel në anesoret e tij. Zinxhiri duhet të ketë gjyrenë e vet xhupit veror.

Lleret me mbyllje me perçina sipas permasave të Xhupit veror dhe në ngjyrën e xhupit.

Në anën e brendshme të majtë ka një xhëp 15x14cm në ngjyrën e xhupit.

Etiketa duhet të jetë e thurur dhe të ketë masen, standardet ISO që ofron, logon e CE dhe instruksionet e larjes. Poshte etiketes një kapese me materialin e xhupit për varje me gjerësi 8mm dhe gjatësi 90mm. Menge të gjata, pjesa e brendshme në ngjyrën e


jashtme. Te kete 2 xhepa ne secilen ane, pozicionuar pjerret ne kend 45 grade qe mbyllen me bordure te jashtme 23mm te gjere dhe bordure te brendshme 14 mm te gjere ne ngjyren e vete xhupit.

Pjesa fundore e xhupit rrethuar ne gjithe perimetrin e tij me nje bordure 20mm. Per te vertetuar parametrat fizike do te analizohet mostra e dorezuar.

ASTARI

Xhupi veor duhet të vishet tek pjesa e trupit me astar në formë rrjete dhe tek mëngët me astar prej tekstili. Astari duhet të qepet tek paramontura. Filli i bazës dhe në ind të jetë i qëndrueshëm në këputje. Të ketë qëndrueshmëri të ngjyrës ndaj larjes, djersës, fërkimit, hekurosjes, etj. Të mos krijohen njolla ndryshku nga pjesët metalike (zinxhiri) pas larjes.

Të jetë e mbuluar tek pjesa e zinxhirit.

	Madhësia dhëmbëve	e 4 CF ose 5 CF	
	Shirit prej tekstili	100% poliester	
	Dhëmbët	100% poliester monofilament	
	Ngjyra	blu NAVY	
Etiketa			
Etiketë prej tekstili për identifikimin e fabrikës, masës, gjinisë, mirëmbajtjes dhe përbërjes.		Përbërja Ngjyra	100% poliester e bardhë
Stampa			
Shkrimi F.S.P.D mbrapa në xhup	Stampim me material/bojë reflektive		
F.S.P.D	Ngjyra	gri, argjend	
	Përmasat referencë	11 x 38 cm	
	Lloji i germës	<i>Myriad Pro Bold</i>	
	Stampa duhet të rezistojë mbi 105 cikle larjeje.		

KUSHTE TË DOMOSDOSHME

Produkti përfundimtar duhet të jetë identik me kampionin e aprovuar gjatë procedurave të vlerësimit.

Filli qepës duhet të ketë ekzakt karakteristikat e përcaktuara tek Specifikimet Teknike.

Tegelat e qepjes së xhupit veor duhet të jenë me hap 4 shpime në 1 cm.

Tegelat duhet të jenë të drejtë, uniformë, simetrik dhe nuk duhet të kenë shqepje ose defekte. Tegelat duhet të jenë të fortë dhe nuk duhet të shqepen nëse tërhiqen me duar.

Fortësia e tegelave duhet të jetë mbi 12N. Tegelat duhet të jenë të përforcuar në ekstremitete. Tegelat qepës tek gavaturat e mëngëve, pjesa e supeve, para dhe pas duhet të jenë të termosduara. Të gjithë elementët e xhupit veor duhet të jenë simetrik. Përpara se të fillojë prodhimi i artikujve, prodhuesi duhet të bëjë testimin e stabilitetit dimensional (aftësinë e tekstilit për të ruajtur formën fillestare pas prerjes, qepjes, larjes, hekurosjes, etj.) Në varësi të llojit, tekstilet nuk duhet të lahen ose hekurosen në temperatura që kalojnë kufijtë e specifikuar nga prodhuesi në skedën teknike sipas EN ISO 3758 ose që janë specifikuar në këtë dokument. Gjithashtu tekstili nuk duhet të fitojë shkëlqim gjatë hekurosjes. Tekstili duhet të ketë rezistencë të lartë ndaj rrezatimit Ultraviolet. Tekstili duhet të ketë rezistencë maksimale ndaj përdorimit dhe

konsumit. Tekstili i xhupit veor nuk duhet të krijojë rrudha gjatë përdorimit. Xhupi veor duhet të jetë i lehtë për tu mirëmbajtur. Kufiri i lejuar i gabimit tek përmasat e xhupit është $\pm 2\%$. Tek qepja e jakës nuk lejohet asnjë kufi gabimi. Vendosja e perçinave në xhup duhet të bëhet rreptësisht sipas përshkrimit tek *Specifikimet Teknike*. Perçinat duhet të kenë pamje të rregullt. Nëse hidhen me forcë në tokë nga një lartësi prej 2 metrash nuk duhet të thyhen, plasariten, gërvishten ose të pësojnë dëmtime të tjera. Elementëve *Velcro* nuk duhet t'u dalin fijet anësore gjatë përdorimit të shpeshhtë. Tekstilet, materialet dhe aksesoret e përdorur në prodhimin e këtij artikulli nuk duhet të përmbajnë substanca të dëmshme për shëndetin e njeriut apo AZO ngjyruës.

a. EN ISO 14362-1:2017

b. EN ISO 14362-3:2017

c. EN ISO 3071:2006 (vlera limit e pH për veshjet që kanë kontakt direkt me lëkurën është 4.0 - 7.5 dhe për veshjet që nuk kanë kontakt direkt me lëkurën është 4.0 - 9.0).

Xhupi veor duhet të pajiset me 3 elementë *Velcro* femër:

1 copë për vendosjen e Logos së gjoksit.

1 copë për Logon e Mbiemrit , me përmasa 8.6 x 3 cm.

1 copë me përmasa 8 x 7 cm me formën e Logos se F.S.P.D-se në mëngën e majtë.

AMBALLAZHIMI DHE ETIKETIMI

Artikulli XHUP VEROR duhet të pajiset me një etiketë prej tekstili, në të cilën duhet të shkruhet ky informacion: emri i fabrikës, viti i prodhimit, masa, gjinia, përbërja dhe instruksionet e mirëmbajtjes. Tek xhepi i brendshëm i djathtë (i veshur) duhet të qepet një etiketë. Perçina rezervë duhet të vendoset në një qese plastike polietileni ose prej kartoni të hollë, të mbyllur mirë. Perçina rezervë duhet të jetë e pranishme tek secili xhup. Ajo duhet të vendoset gjatë paketimit në etiketën e xhupit me një fije plastike të siguruar mirë. Në momentin e dorëzimit xhupat veor duhet të jenë të pastër, të hekurosur dhe pa njolla. Xhupat e palosur duhet të futen në qese polietileni. Në çdo kuti duhet të vendosen xhupa të së njëjtës masë dhe gjinie. Çdo kuti duhet të ketë një sasi të barabartë xhupash. Kartoni i kutive (me peshë rreth 600 gr/m²) duhet të jetë i përshtatshëm për transportin e sigurt të produkteve. Çdo kuti duhet të jetë e pajisur me një etiketë me adeziv, në të cilën duhet shënuar masa e xhupit, gjinia, viti i prodhimit, sasia dhe emri i fabrikës prodhuese. Kutitë duhet të jenë të padëmtuara dhe të izoluara me shirit ngjitës (natriban).

MASAT DHE SASIA E PRODHIMIT

Artikulli XHUP VEROR do të porositet dhe do të prodhohet në masat XS – XXXL për femra dhe S – XXXL për meshkuj, dhe në sasi të që do të rezultojnë pas matjeve të punonjësve të *Punonjësve të Sigurisë Portit Durrës*.

Marrja e masave trupore

Marrja e masave trupore të mëposhtme është e nevojshme për nxjerrjen e përmasave të këtij artikulli:

Artikulli konsiderohet teknikisht i pranuar kur ai plotëson të gjitha kërkesat e këtij Specifikimi Teknik

Cope: 140 (njqind e dyzetë) Copë.

8- Pulover e holle vere

Specifikimi Teknik i artikullit “**Pulover e holle vere**” për Forcat e Sigurisë së APD paraqet kërkesat themelore teknike të domsdoshme. **Te gjitha percaktimet teknike të këtij Specifikimi Teknik duhen të zbatohen detyrimisht sakte nga prodhuesi.**

Treguesit fiziko-mekanik e kimik të lëndës së I-re trikotazh **Blu Navy** si dhe të materialeve të tjera ndihmëse që do të përdoren për konfeksionimin e artikullit

“Pulover e holle vere” duhet te rezultojne te jene domosdosmerisht ne perputhje me Specifikimet Teknike te meposhtme.

Materialet qe duhet te perdoren per prodhimin e artikullit “Pulover e holle vere” jane:

Lenda e I-re

Trikotazh termik ,cilesia e I-re me keto te dhena:

ngjyra	Blu Navy
perberja	100% akrelik
thurja	llastik 1+1
masa e pulovres gr/cope	300 +/- 10 gr
dendesia syth/10 cm	D -vertikale 70 +/-1 syth D- horizontale 60 +/-1 syth
numri metrik	Nm 40/2
trashesia e tekstili	1-3 mm
qendrueshmeria e ngjyres	Nota 4-5

Per qepjen dhe ndertimin e spalinave dhe fortesave tek supi dhe tek brylat e mengeve do te perdoret dok trikoton me ngjyre Blu Navy tekstil te zgjahu i cili duhet te jete me perberje 65 % PES + 35 % pambuk,qendrueshmeri ngjyre Nota 4-5 dhe me thurje sarzh.

Materialet ndihmese qe duhet te perdoren per ndertimin e artikullit “Pulover e holle” jane :

Kollaritje qe eshte material tekstili ngjites me fortese te plote per te perforcuar spalinat **Dok trikoton** me ngjyre Blu Navy tekstil te zgjahu i cili duhet te jete me perberje 65 % PES + 35 % pambuk dhe thurje sarzh.

Penj qepje Nm 80/2 100 % PES Blu Navy

Velkrofe femer me ngjyre Blu Navy

PERSHKRIM

Pulovra perbehet nga jaka ne forme **gjysem golf(rrumbullake) me zinxhir pergjate gjithe pjese ballore te pulovres**,menget,shpina,gjoksi,spalinat dhe fortesat dok terikoton ne ngjyre Blu Navy ne sup dhe ne brryl. Ne krahu e majte ne krahu e djathte te gjoksit vendosen velkrofet femer ne ngjyre Blu Navy per vendosjen e Logove ne gjoks dhe Logos se mbiemrit. Velkrof femer vendoset edhe ne mengjen e majte per vendosjen e logos ne krahe.

Jaka e pulovres eshte ne forme Gjysem golf dhe te perfundoje me zinxhirin i cili fillon nga pjesa fundore e pulovres.Bordura e jakes duhet te jete trikotazh me thurje llastik 1+1.Gjeresia e bordures se jakes te montuar ne trupin e pulovres duhet te jete 3 cm +/- 1 mm.Spaletat duhet te jene drejtkendore ne njeren ane dhe me kulm (me forme shigjete) ne anen tjetere. Ana drejtkendore duhet te qepet tek tegeli i rrethit te menges (gavatura). Katere brinjete e tjera pershkohen nga nje tegel perimetral sipërfaqësor nje gjilpërësh me distancë rreth 5 mm nga buza. Spaleta duhet te ndërtohet me dy shtresa tekstili ngjyre blu navy (njësoj si Pulovra e Holle vere) me permasa te njajta.

Shtresa e sipërme e spaletës duhet te perforcohet me frazeline termoadezive.Perçina duhet te jete ne anen e “shigjetës”, distancë rreth 1.5 cm nga kulmi.Perçina duhet te qepet ne te njajtin pozicion tek supi Pulovres se holle vere. Perçina duhet te jete me diameter 17 mm, metalike, ngjyre blu navy.

Gjatësia e spaletës duhet te ndryshojë ne varësi te masës së Pulovres se holle vere. Gjatësia e spaletës duhet te rritet me 2-3 mm per çdo masë. Permasat bazë duhet te jene keto: 13.5 x 4.8 cm per masen me te vogel te Pulovres se holle vere dhe 18 x 4.8 cm per masen me te madhe te Pulovres se holle vere.

Mengeve iu montohen me qepje fortesat prej doku terikoton ne pjesen e brylit te cilat duhet te shtrihen duke u puthitur mire dhe pa rudha me siperfaqen e trikotazhit.Fortesa prej doku duhet te mbuloje ne menyre simetrike te gjithe siperfaqen e brylit.

Per qepjen dhe ndertimin e spalinave dhe fortesave tek supi dhe tek brylat e mengeve do te perdoret dok terikoton me ngjyre Blu Navy.

Pulovra duhet te jete simetrike ne te gjithe elementet e saj.

AMBALLAZHIMI DHE ETIKETIMI

Artikulli **Pulover e holle vere** duhet te pajiset me nje etikete prej tekstili, ne te cilen duhet te shkruhet ky informacion: emri i fabrikes, viti i prodhimit, masa, gjinia, përbërja dhe instruksionet e mirëmbajtjes.

Në momentin e dorëzimit **Pulover e holle vere** duhet te jene te pastër, te hekurosur dhe pa njolla. **Pulover e holle vere** e palosur duhet te futen ne qese polietelieni. Ne çdo kuti duhet te vendosen **Pulover e holle vere** te se njëjtës masë dhe gjinie. Kartoni i kutive (me peshë rreth 600 gr/m²) duhet te jete i përshtatshëm për transportin e sigurt te produkteve. Çdo kuti duhet te jete e pajisur me nje etikete me adeziv, ne te cilen duhet shënuar masa e **Pulover e holle vere**, gjinia, viti i prodhimit, sasia dhe emri i fabrikes prodhuese. Kutite duhet te jene te padëmtuara dhe te izoluara me shirit ngjitës (natriban).

xhiro gome e presuar me fiapen me pjeresi konike,trashesi 2.8-3 mm dhe gjeresi 17-19 mm.

sholle gome e presuar TIP U me fortessi 75 +/- 3 grade shore (sipas STASH 2638 – 87) te presuar,nga poshte duhet te jete me llokma te dhembzuara, me trashesi 7-8 mm pa llokma, ndersa me llokma trashesia duhet te jete13-14 mm.

taka duhet te jete e presuar se bashku me shollen me trashesi 25-26 mm

pe sintetik me ngjyre te zeze per qepje e lekures 100 % sineteik dhe qëndrueshmeri mbi 9 kG,per masurin Nm 40/3 dhe gjilperën Nm 30/3

pe sintetik i thurur 1 mm per qepje 100 % PES dhe rezistence 38 kG (1000 g)

taban soleti lekure me trashesi 3-3.5 mm

lidhese te zeza te rrumbullakta thurje gershet deri ne 60 cm gjatesi

- Të jenë kundra rrëshqitjes.
- Të krijojnë lehtësi në mbathjen e z bathjen e tyre.
- Lëkura të jetë “ëaterproof”, e cilësisë së parë dhe higjienike.
- Të jenë rezistente në shqitje të gomës.
- Të jenë rezistente ndaj plasjes së faqes dhe në këputje të saj.
- Pjesa e brendshme të mos lëshojë bojë.

Ngjyra e zezë.

Raporti midis gjatesise dhe gjerese ne varesi te numrit te kepuceve te plotesoje kushtet e standartit shqiptar.

Për te vertetuar parametrat fizike do te analizohet mostra e dorezuar.

Artikulli konsiderohet teknikisht i pranuar kur ai plotëson të gjitha kerkesat e ketij Specifikimi Teknik

Cope: 140 (njëqind e dyzetë) palë.

22-Bluzë pambuku me mëngë të gjata

Përshkrim i detajuar

Bluzë e ndërtuar nga pëlhura poliestër pambuk me thurje fije 3 fijesh tute e qethur, e cila te jete e butë në prekje dhe e rehatshme për t'u veshur. Te kete te stampuar logon e A.P.D. Per larje në lavatriçe në temperaturë mesatare deri në 60°. Specifikimi Teknik i artikullit “**Bluzë pambuku me mence te shkurtra**” paraqet kërkesat themelore teknike të domsdoshme.

Të gjitha përcaktimet teknike të këtij Specifikimi Teknik duhen të zbatohen detyrimisht saktë nga prodhuesi.

Treguesit fiziko – mekanik e kimik të lëndës së I-rë trikotazh ngjyrë **blu e errët** si dhe të materialeve të tjera ndihmëse që do të përdoren për konfeksionimin e artikullit “**Bluzë**” duhet të rezultojnë të jenë domosdosmërisht në përputhje me Specifikimet Teknike të mëposhtme.

Materialet që duhet të përdoren për prodhimin e artikullit “**Bluzë**” janë:

Lënda e I-rë trikotazh materiali tre-fijesh i qethur **blu e errët**, cilësia e I-rë me këto të dhëna:

Bluza duhet të jete e certifikuar sipas standardit nderkombetar OKEOTEX Standard 100

Ngjyra	blu e errët
Përbërja	80% pambuk, 20% polietser
Thurja	Trefijesh I qethur
Masa gr/m²	280 +/- 5 gr
Dendësia syth/10 cm	D vertikale 210 +/-8 syth D horizontale 280 +/-8 syth
Qendrueshmëria kG	Q v/h 18 - 3 kG
Metrik	Nm 50/1
Trashësia e tekstili	0.5 +/- 0.1 mm
Qendrueshmëria e ngjyrës	Nota 4-5

Vlera e qendrueshmërisë së ngjyrës së lëndës I- re trikotazh materiali tre-fijesh i qethur **blu e errët** duhet të jetë e qendrueshme dhe shumë e qendrueshme **Nota 4 - 5**. Ngjyra e mostrës e cila i nënshtrohet provës në qendrueshmëri ndaj fërkimit në të thatë dhe në të njomë, në larje solucioni sapuni dhe djersë nuk duhet të ndryshojë nga ajo e depozituara në ofertë.

Materialet ndihmëse që duhet të përdoren për ndërtimin e artikullit “**Bluze**” janë:

Penjë qepje Nm 80/2 100 % PES blu e errët

PËRSHKRIM

Bluza me mëngë të gjata është model me jakë rrumbullake. Përbëhet nga jaka , mëngët, shpina dhe gjoksi.

Jaka e bluzës është rrumbullake dhe duhet të jete trikotazh methurje llastik 1+1.

Gjoksit lart në të dyja anët i qepet me tegela anësore dygjilperesh. Gjoksit dhe shpinës i formohet në fund bordura me gjerësi **3-5 cm +/- 1 mm** duke palosur një herë trikotazhin në fund dhe duke kaluar pastaj tegel dysh zbkurimi..

Mëngët te gjata në fund janë me bordurë me gjerësi **3-5 cm** dhe me material trikotazh methurje llastik 1+1. Në fillim bashkohet gjoksi me shpinën dhe pastaj fiksohen dhe mëngët . Mbyllja e bluzës fillon me bashkimin anësor të shpinës me gjokset dhe vazhdon me mbylljen e mengeve. Pastaj kryhet vendosja e jakës duke bërë kujdes që në përfundim jaka të jetë e shtrirë mirë duke mos krijuar vende të ngritura. Të gjithë bashkimet e pjeseve përbërëse të bluzës (tegelat) duhet të rëalizohen me makina të posaçme për qepjen e trikotazheve (makina qepje dygjilpërshe me grepa).

Tegelat e qepjes të bluzës duhet të jenë me hap **30** shpime në **5 cm**. Tegelat duhet të jenë të fortë, uniform, të mos kenë vende të shqepura, të jenë simetrike, të rrëgullt dhe të drejtë. Tegelat duhet të jenë të fortë në mënyrë të tillë që të mos hapen nën ushtrimin e forcës së duarve. Fortësia e tegelave të jetë mbi **12 kg**. Tegelat duhet të jenë të përforcuar në fund. Peri që do të përdoret për qepje duhet të jetë i fortë dhe me ngjyrë të errët me **Nm 80/2, 100 % PES**.

Bluza duhet të jetë simetrike në të gjithë elementët e saj.

Artikulli “**Bluzë**” prodhohet dhe porositet nga përdoruesi në sasi të përkatëse sipas masave të gjokseve **S, M, L, XL, XXL** të cilat subjekti prodhues është i detyruar ta respektojë saktësisht.

Amballazhi, marketimi dhe etiketimi

Çdo bluzë futet në qese telefoni dhe paketimi i tyre bëhet në kuti kartoni në sasi që pesha e tyre të mos shkaktojë deformim të kutisë. Mbi kuti vendoset etiketa ku të jetë shkruar qartë emri i

firmës, numri i gjoksit, sasia dhe vula përkatëse.

Artikulli konsiderohet teknikisht i pranuar kur ai plotëson të gjitha kërkesat e këtij Specifikimi Teknik.

Cope: 280 (dyqind e tetëdhjetë) palë.

23-Bluze pambuku me minge te shkurtra

Përshkrim i detajuar

Bluzë e ndërtaur nga pëlhura poliestër/pambuk me thurje xhersi, e cila te jete e butë në prekje dhe e rehatshme për t'u veshur. Te kete te stampuar logon e A.P.D. Per larje në lavatriçe në temperaturë mesatare deri në 60°. Specifikimi Teknik i artikullit “**Bluzë pambuku me minge te shkurtra**” paraqet kërkesat themelore teknike të domsdoshme.

Të gjitha përcaktimet teknike të këtij Specifikimi Teknik duhen të zbatohen detyrimisht saktë nga prodhuesi.

Treguesit fiziko – mekanik e kimik të lëndës së I-rë trikotazh ngjyrë **blu e errët** si dhe të materialeve të tjera ndihmëse që do të përdoren për konfeksionimin e artikullit “**Bluzë**” duhet të rezultojnë të jenë domosdosmërisht në përputhje me Specifikimet Teknike të mëposhtme.

Materialet që duhet të përdoren për prodhimin e artikullit “**Bluzë**” janë:

Lënda e I-rë trikotazh **blu e errët**, cilësia e I-rë me këto të dhëna:

Bluza duhet te jete e certifikuar sipas standardit nderkombetar OKEOTEX Standard 100

Ngjyra	blu e errët
Përbërja	100% pambuk
Thurja	xhersi (e thjeshte) 1+1
Masa gr/m²	155 +/- 5 gr
Dendësia syth/10 cm	D vertikale 210 +/-8 syth D horizontale 155 +/-8 syth
Qendrueshmëria kG	Q v/h 18 - 3 kG
Metrik	Nm 50/1
Trashësia e tekstili	0.5 +/- 0.1 mm
Qendrueshmëria e ngjyrës	Nota 4-5

Vlera e qendrueshmërisë së ngjyrës së lëndës **I-** re trikotazh **blu e errët** duhet të jetë e qendrueshme dhe shumë e qendrueshme **Nota 4 - 5**. Ngjyra e mostrës e cila i nënshtrohet provës në qendrueshmëri ndaj fërkimit në të thatë dhe në të njomë, në larje solucioni sapuni dhe djersë nuk duhet të ndryshojë nga ajo e depozituara në ofertë.

Materialet ndihmëse që duhet të përdoren për ndërtimin e artikullit “**Bluze**” janë:

Penjë qepje Nm 80/2 100 % PES blu e errët

PËRSHKRIM

Bluza me mëngë të shkurtra eshte model T-shirt me jakë rrumbullake. Përbëhet nga jaka , mëngët, shpina dhe gjoksi.

Jaka e bluzes eshte rrumbullake dhe duhet te jete trikotazh me thurje llastik 1+1.

Gjoksit lart në të dyja anët i qepet me tegela anesore dygjilperesh. Gjoksit dhe shpinës i formohet në fund bordura me gjerësi **3 cm +/- 1 mm** duke palosur një herë trikotazhin në fund dhe duke i kaluar pastaj tegel dysh zbukurimi.

Mëngët ne fund jane me bordurë me gjerësi **2-2.5 cm** dhe me material trikotazh me thurje llastik 1+1. Në fillim bashkohet gjoksi me shpinën dhe pastaj fiksohen dhe mëngët . Mbyllja e bluzës fillon me bashkimin anësor të shpinës me gjokset dhe vazhdon me mbylljen e mingeve. Pastaj kryhet vendosja e jakës duke bërë kujdes që në përfundim jaka të jetë e shtrirë mirë duke mos krijuar vende të ngritura. Të gjithë bashkimet e pjeseve përbërëse të bluzës (tegelat) duhet të rëalizohen me makina të posaçme për qepjen e trikotazheve (makina qepje dygjilpërshë me grepa).

Tegelat e qepjes të bluzës duhet të jenë me hap **30** shpime në **5 cm**. Tegelat duhet të jenë të fortë, uniform, të mos kenë vende të shqepura, të jenë simetrike, të rrëgullt dhe të drejtë. Tegelat duhet të jenë të fortë në mënyrë të tillë që të mos hapen nën ushtrimin e forcës së duarve. Fortësia e tegelave të jetë mbi **12 kg**. Tegelat duhet të jenë të përforcuar në fund. Peri që do të përdoret për qepje duhet të jetë i fortë dhe me ngjyrë të errët me **Nm 80/2, 100 % PES**.

Bluza duhet të jetë simetrike në të gjithë elementët e saj.

Artikulli “**Bluzë**” prodhohet dhe porositet nga përdoruesi në sasi të përkatëse sipas masave të gjokseve **S, M, L, XL, XXL** të cilat subjekti prodhues është i detyruar ta respektojë saktësisht.

Amballazhimi, marketimi dhe etiketimi

Çdo bluzë futet në qese celofoni dhe paketimi i tyre bëhet në kuti kartoni në sasi që pesha e tyre të mos shkaktojë deformim të kutisë. Mbi kuti vendoset etiketa ku të jetë shkruar qartë emri i firmës, numri i gjoksit, sasia dhe vula përkatëse.

Artikulli konsiderohet teknikisht i pranuar kur ai plotëson të gjitha kërkesat e këtij Specifikimi Teknik.

Cope: 280 (dyqind e tetëdhjetë) palë.

24 – KOSTUM SPORTIV VEROR (nje Bluzë dhe nje pale Mbathje) .

Specifikimi Teknik i artikullit “Kostum sportiv veror” për punonjësit e FSPD -s në APD, paraqet kërkesat themelore teknike të domsdoshme.

Të gjitha përcaktimet teknike të këtij Specifikimi Teknik duhen të zbatohen detyrimisht saktë nga prodhuesi.

Specifikimi teknik i artikullit, “Kostum sportiv veror” paraqet kërkesat themelore teknike të domsdoshme për prodhimin në linjë industriale mbi bazën e proceseve teknologjike. Materialet që duhet të përdoren për prodhimin e artikullit “Kostum sportiv veror” janë:

Kostumi sportiv duhet të jete e certifikuar sipas standardit nderkombetar OKEOTEX Standard 100

Lënda e I-rë

Tekstil me përbërje poliester 33% dhe pambuk 67%

PËRSHKRIMI

Artikulli “Kostum sportiv”, përfshin bluzë me mëngë të shkurtra dhe mbathje të shkurtra. Në pjesën e brendshme të bluzës dhe mbathjeve ka të qepur një rrjetë në formë astari e cila shërben për thithjen e djersës. Artikulli “Bluzë sportive” të jetë i modeluar me jakë të rrumbullakët i përbërë nga, pjesa përpara (përparësja), pjesa mbrapa (shpina) dhe dy mëngë të shkurtera, paraqet një jakë të hapur në formë të rrumbullakët e cila përfundon me një shirit me lartësi rreth 12 mm. Pjesët e ndryshme janë bashkuar (montuar) në linjën anësore, në linjën e supit dhe në gavaturë (rreth mënge) me tegel me makinë syzator. Linja fundore e bluzës si në pjesën përpara ashtu dhe në pjesën prapa dhe linja fundore të mëngës, përfundojnë me një kthim pale me lartësi rreth 20 mm të realizuara me tegel linear dygjilpërësh.

Artikulli “Mbathje sportive” të jetë i modeluar sportive të shkurtera ku pjesa e sipërme të jete me llastik dhe vend syzator plastic për vendosjen e një shiriti tekstil (ushkur). Linja fundore e kembezave të përfundojnë me një kthim pale me lartësi rreth 20 mm të realizuara me tegel linear dygjilpërësh

Bluza duhet të jete simetrike në të gjitha elementet e saj.

Për të vertetuar parametrat fizike do të analizohet mostra e dorëzuar.

Ngjyrat të jenë të ndryshme ku të mbizoteroje ngjyra kuqe me të zeze si dhe kombinacione të tjera të mundshme.

Artikulli “Kostum Sportiv” prodhohet dhe porositet nga përdoruesi në sasi të përkatëse sipas

masave të gjokseve S, M, L, XL, XXL të cilat subjekti prodhues është i detyruar ta respektojë saktësisht.

AMBALLAZHIMI, MARKETIMI DHE ETIKETIMI

Çdo kostum futet në qese celefoni dhe paketimi i tyre bëhet në kuti kartoni në sasi që pesha e tyre të mos shkaktojë deformim të kutisë. Mbi kuti vendoset etiketa ku të jetë shkruar qartë emri i firmës, numri, dhe vula përkatëse.

Artikulli konsiderohet teknikisht i pranuar kur ai plotëson të gjitha kërkesat e këtij Specifikimi Teknik

Cope: 140 (njëqind e dyzetë) palë.

SPECIFIKIMET TEKNIKE TE SHERBIMIT MZSH

Specifikimet Teknike të artikujve të mëposhtëm janë hartuar në përputhje me V.K.M-në Nr.1153 dt.24.12.2020 “PËR MIRATIMIN E UNIFORMËS, SHENJAVE DALLUESE PËRKATËSE, FLAMURIT DHE STEMËS SË SHËRBIMIT TË MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIN” dhe për sasinë e artikujve sipas tabelës së Miratuar në planin e blerjeve të A.P.D ,aneksi shpenzimeve për veshmbathje.

Këto *Specifikime Teknike* parashtrojnë në mënyrë të detajuar kërkesat themelore teknike të domosdoshme për ndërtimin e prototipit dhe prodhimin e artikullit.*Specifikimet Teknike* përcaktojnë gjithashtu edhe kërkesat teknike të aksesorëve që duhet të shoqërojnë artikullin.

ARTIKUJT:

1. XHUP TREÇEREKSH DIMËROR për punonjësit e MZSH në A.P.D.

Xhupi ka shtresë të brendshme dhe është me ngjyrë blu të errët. Është konfeksionuar në 8 prerje (XS–S–M–L–XL–XXL–XXXL–4XL).

Prej pjesës së kraharorit deri te lartësia e gjoksit dhe përmes shpinës është e përforcuar dhe ka shtresën e brendshme që arrin deri te fundi i mëngës.

Në pjesën e poshtme të xhupit nga të dy anët janë të vendosura dy xhepa të thellë me kapakë.

Xhupi është me gjatësinë e duhur/të përshtatshme dhe arrin deri mbi gjunjët.

MASAT E PRODHIMIT TË XHUPIT

TABELA E PËRMASAVE

(dimensionet e shprehura në cm – tolerancë +/- 3%)

MASAT	XS	S	M	L	XL	2XL	3XL	4XL
1/2 e gjerësisë së kraharorit (e matur në pjesën e poshtme të sektorit)	60	60	64	70	73	79	81	84
Gjerësi shpatullash	47	47	51	53	55	57	59	62
Gjatësia totale (e matur nga tegeli qepës i linjës së supeve në afërsi të jakës deri në fund)	64	67	71	74	77	79	81	83
Gjatësia e mëngës (e matur duke ndjekur formën e modelimit të bërrylit)	59	59	65	67	69	70	73	73

PËRSHKRIMI - KONSTRUKTIMI

Xhupi treçereksh është realizuar me tekstil, me ngjyrë blu dhe përbëhet nga këto elemente:

- përpara (me dy pjesë, gjokset);
- shpina (pjesa pas);
- jaka;
- dy spaleta;

- dy mëngë;
- një shtresë e brendshme.

Jaka	Realizuar model korean me lartësi rreth 7,5 cm. Mbyllja dhe hapja e saj kryhet me anë të zinxhirit me ngjyrë blu në tonalitet me tekstin e xhupit.
Përpara	Dy pjesët përpara bashkohen ndërmjet tyre përgjatë linjës qendrore në të gjithë gjatësinë e tij me anë të një zinxhiri tip 8 dhëmbësh, anët e të cilit mbulohen nga jashtë me anë të një mostre të realizuar me tekstil dopio me gjerësi rreth 5 cm. Linja fundore e xhupit përpara, përfundon me një kthim pale (tegel njëgjilpërësh).
Xhepat	Xhupi ka katër xhepa me kapakë, të pozicionuar përkatësisht: dy xhepa në lartësinë e gjoksit dhe xhepat e poshtëm të pozicionuar përgjatë linjës së belit. Kapakët janë realizuar me tekstil dopio të përforcuar me frazelinë ndërmjet dy shtresave të tekstit në brendësi dhe përfundojnë me kulme. Hapja dhe mbyllja e xhepave me kapakët realizohet me anë të velkrofëve “mashkull” – “femër”, të aplikuar në pjesën e brendshme të kapakëve, në korrespondencë me velkrofët e montuar në xhepa.
Shpina	Është realizuar me një pjesë. Bashkohet me pjesët e tjera në gaturë (rreth mënge) me anë të syzatorit, ndërsa në pjesët përpara në anësor me tegel linear. Linja fundore e xhupit pas përfundon me një kthim pale (tegel njëgjilpërësh).
Mëngët	Mëngët janë realizuar me dy pjesë: një mëngë e sipërme dhe një mëngë e poshtme. Mëngët bashkohen me trupin e xhupit me anë të syzatorit dhe tegelit linear njëgjilpërësh. Dy mëngët përfundojnë në linjën fundore me një palosje të brendshme me lartësi rreth 2 cm. Pjesa fundore e mëngës paraqet, në tegelin qepës të poshtëm në të dy pjesët përbërëse të saj, një gjuhëz, baza e të cilës është montuar në tegelin qepës. Tre drejtimet e tjera janë përshkuar me tegel linear perimetral njëgjilpërësh nga bordet. Në pjesën e poshtme të gjuhëzës është aplikuar një velkrof “mashkull”, në korrespondencë me të, në fund të mëngës, është montuar në drejtim horizontal një shirit velkrofi “femër”. Gjuhëza bën të mundur rregullimin e linjës fundore të mëngës për përshtatje të perimetrit të kyçit të dorës.
Spaletat	Spaletat janë montuar në linjën e supeve. Janë realizuar me dy shtresa tekstili, në formë drejtkëndore fundi i lirë i të cilave përfundon me kulm me majë. Baza (ana drejtkëndore e spaletave) montohet në rrethin e mëngës. Në skajin e lirë, me kulm me majë, të pjesës së poshtme të spaletës, është aplikuar një shirit velkrofi “femër” në formë drejtkëndor. Në korrespondencë me të është aplikuar një velkrof “mashkull”, të cilat bëjnë të mundur fiksimin e spaletës.
Pjesa e brendshme	Në brendësi të xhupit është aplikuar një “xhup” i brendshëm i realizuar me një shtresë me mbushje me vatinë, e cila është aplikuar ndërmjet dy shtresave të tekstit 100% poliester (astar) të realizuar me tegela në formë romboidale. Pjesa e brendshme përbëhet nga: jaka, dy pjesët përpara, shpina, mëngët.

Etiketa	Në pjesën e brendshme të xhupit treçereksh në lartësinë e jakës në pjesën e prapme janë aplikuar etiketat e mëposhtme: etiketa me demonstrimin e firmës furnizuese; etiketa me udhëzimet e prerjes; treguesi i përbërjes së tekstilit me vitin e fabrikimit, si dhe instruksionet e larjes; mirëmbajtja.
---------	--



Për te vertetuar parametrat fizike do te analizohet mostra e dorezuar.

Artikulli konsiderohet teknikisht i pranuar kur ai plotëson të gjitha kërkesat e këtij Specifikimi Teknik

Cope: 40 (dyzetë) Copë.

2- Kostum shërbimi (1 xhakete+ 2 pantallona+2 kapele)

KOSTUM PUNE VERE DOK TRIKOTON (1 XHAKETA, 2 PANTALLONI, 1 KAPELE)

Kostum pune vere, materiali duhet të jetë dok, ngjyra blu e errët, e qepur me blu e cila përmban (xhakete, pantallona dhe kapele).

XHAKETA

Materialet ndihmëse që duhet të përdoren për prodhimin e artikullit “Xhakete” janë:

- Dok trikoton;
- Penj qepje, blu e errët me ngjyrën e dokut;
- Velkrofe “femër” me ngjyrë blu të errët.

Artikulli xhakete “Kostum pune vere” prodhohet në bazë të gjatësive trupore dhe porositet nga përdoruesi në sasi të përkatëse sipas numrave të gjokseve, të cilat subjekti prodhues është i detyruar t’i respektojë saktësisht.

Përmasat e duhura të elementeve, të cilat bëjnë pjesë në ndërtimin e artikullit “Kostum pune vere”, janë:

- Xhaketa përbëhet nga jaka, shpina, mëngët, gjokset, dorezat e mëngëve, bordura përpara, xhepat e poshtëm anash, sipër në gjoksin e majtë vendoset velkrof “femër” në formë drejtkëndëshi me ngjyrë të zezë, bordura e poshtme dhe astari i brendshëm, shirita fosforeshente

te krahu i majtë e i djathtë, shirit fosforeshent te gjoksi sipër dhe shiriti fosforeshent është te pjesa fundore e xhupit.

- Gjoksi i majtë dhe i djathtë përpara ka një shirit fosforeshent në ngjyrë gri metalizato me përmasa 6 cm të gjerë, të cilës në të dy anët gjatë gjithë gjatësisë i kalohen tegelat e zbukurimit 5 mm larg buzëve. Në anën e majtë të kraharorit vendoset xhepi i kraharorit për radio 15x3 cm. Sipër xhepit të radios vendoset velkrof në ngjyrë blu për vendosjen e shenjës së emrit.

-Shpina mbrapa në pjesën e sipërme do të vendoset një shirit me përmasa në lartësi 15 cm, dhe gjerësi sa ajo ndërmjet gavaturave. Ngjyra e shiritit do të jetë gri metalizato, mbi të cilën do të shkruhet me shkronja shtypi “ZJARRFIKËS”. Shkrimi do të jetë ngjyrë blu e errët.

PANTALLONAT

Pantallonat janë me ngjyrë blu të errët, me prerje të gjerë, me përbërje të njëjtë si xhaketa; Në pjesën e sipërme, në anën e majtë dhe të djathtë, kanë nga një xhep me prerje të pjerrtë; Në anën e majtë dhe në anën e djathtë, në lartësinë mbi gjunjë, janë të qepur dy xhepa në formë harmonike me kapakë, të cilët mbërthehen me ngjitëse.

Për te vertetuar parametrat fizike do te analizohet mostra e dorezuar.

KAPELA

- Kapela duhet te jetë dok, blu e errët, e qepur me pe blu të errët;
- Materialet ndihmëse që duhen të përdoren për prodhimin e artikullit “kapelë” janë:
- dok, blu e errët;
- penj qepje, me ngjyrën e dokut;
- stema e kapelës.

Artikulli konsiderohet teknikisht i pranuar kur ai plotëson të gjitha kerkesat e ketij Specifikimi Teknik

Sasia: 40 (dyzetë) Komplete.

3-Rrip pantallonash

Rripi për pantallona është i punuar prej lëkurës së zezë, të gjerësisë 3 cm dhe me togës metalike.



Artikulli konsiderohet teknikisht i pranuar kur ai plotëson të gjitha kerkesat e ketij Specifikimi Teknik

Sasia :40 (dyzet)copë.

4- Bluze me mëngë të gjata

Bluza me mëngë të gjata duhet të jetë modeluar me tekstil trikotazh *jersey*, me jakë të mbyllur të rumbullakët, me ngjyrë blu të errët.

I. KONSTRUKTIMI (MODELIMI) I T-SHIRT-it “BLUZËS” ME MËNGË TË GJATA

T-shirt-i i modeluar me jakë të rumbullakët është i përbërë nga:

- Jaka;

- përpara;
- shpina;
- mëngë të gjata në formë tubolare.



Jaka	Jakë e mbyllur e rrumbullakët, me bordurë e cila përfundon me një shirit me lartësi rreth 12 mm.
Përpara	Përpara me një pjesë, bashkohet në anësor (montuar) me pjesën pas me tegel makine.
Shpina	Shpina është realizuar me një pjesë. Linja fundore e <i>t-shirt</i> -it si në pjesën përpara ashtu dhe në pjesën pas përfundon me një kthim bordure rreth 2 cm.
Mëngë të gjata	Mëngët duhet të jenë të gjata me një pjesë, në formë tubolare. Mëngët përfundojnë me një bordurë me gjerësi 3,5 cm.
Velkrof	Në gjoksin e anës së majtë vendosen velkrofet “femër” në ngjyrë blu të errët, për fiksimin e stemës me shkronja kapitale “MZSH”.

III. TABELA E PËRMASAVE PËR MESHKUJ

	<i>T-shirt me mëngë të gjata blu</i>	XS	S	M	L	XL	2XL
A	Gjatësia totale e <i>t-shirt</i> -it	62	66	69	72	75	77
B	½ e gjerësisë (perimetrit) të gjoksit	41	45	49	53	57	61
C	Gjerësia e shpatullave	38	42	46	50	54	58
D	Lartësia e mëngës në montim	24	25	27	28	29	30
E	Gjatësia e mëngës	59	61	64	64,5	65	66
F	1/2 e perimetrit të kyçit të dorës	9	9	10	11	11.5	12
G	Gjerësia e jakës pas (1/2 e perimetrit të qafës)	15,5	16,5	17,5	18,5	19,5	20,5
K	½ e gjerësisë në fund (linjës fundore)	41	45	49	53	57	61
M	Gjerësia (perimetri) e krahut	18	20	22	23	24	25

PËRMASAT STANDARDE:

Lartësia e jakës (hapja e jakës) përpara 8 cm;
 Lartësia e kthimit të palës së mëngës 2 cm;
 Gjerësia e jakës 1,2 cm.

MATERIALET NDIHMËSE QË DUHET TË PËRDOREN PËR PRODHIMIN E ARTIKULLIT “BLUZË ME MËNGË TË GJATA”

Tekstil *jersey* trikotazh me përbërje pambuku (*cotton*), me ngjyrë blu të errët;
Fill qepës 100 % poliester, me ngjyrën blu të errët në tonalitet me tekstin trikotazh.

Artikulli konsiderohet teknikisht i pranuar kur ai plotëson të gjitha kërkesat e këtij Specifikimi Teknik

Sasia: 160 (njeqind e gjashtedhejtë) copë.

5- Këpuce dimërore

Këpucët me qafa dimërore janë realizuar nga elemente prej lëkure dhe gome dhe përbëhen nga këto pjesë dhe aksesore:

- faqet e këpucës (faqe e përparme dhe faqet anësore);
- maja;
- përforcues i brendshëm;
- astar i brendshëm;
- thembra;
- shtroja (mbështetësja);
- shollë.

FAQET

Faqet e këpucës me qafa përbëhen nga pjesët (faqet e përparme, dy faqe kambale (faqe anësore) thembra, dhe llapa të cilat bashkohen me tegel qepës linear njëgjilpërësh dhe dygjilpërësh. Lëkura e përdorur është me trashësi 1.8–2,00 mm. Dy faqet anësore të këpucës përfundojnë me një mbivendosje bordure të sipërme të bashkuar me anë të tegelit linear dygjilpërësh perimetral. Gjithashtu, ky tegel është aplikuar dhe për efekt estetik.

Në faqet anësore janë montuar në lartësinë e qafës së këmbës (samarin e këmbës) katër vrime të veshura me hekur të cilat lejojnë shtrëngimin e këpucës nëpërmjet lidhëseve prej pambuku. Faqet bashkohen me shtrojen, xhiron rrethuese, dhe shollën nëpërmjet procesit të ngjitjes dhe tegelave qepës.



MAJA

Është realizuar me material prej pambuku të presuar me ngjitës me bazë laktike me trashësi rreth 0,8 mm, e aplikuar në pjesën e përparme nga brenda këpucës, ndërmjet astarit dhe faqes së sipërme të këpucës si te Kampioni Zyrtar.

PËRFORCUES I BRENDSHËM

I realizuar prej materiali plastik me trashësi rreth 1,4 mm është aplikuar në anën e pasme ndërmjet faqes së jashtme dhe astarit të brendshëm dhe është modeluar si te Kampioni Zyrtar.

ASTAR I BRENDSHËM

Pjesa e brendshme e këpucës: llapa, faqet (anësore dhe ballore) janë të realizuara me astar prej lëkure. Astar i prej lëkure është i aplikuar në tri pjesë, të gjitha të ekspozuara nga pjesa e sipërme e lëkurës. Astar i prej lëkure: pjesa e jashtme e saj është aplikuar përgjatë anëve të këpucës dhe është fiksuar me faqen e përparme me gjysmë ngjitje; ndërsa është bashkuar me tegel qepës perimetral të brendshëm.

THEMBRA

Është realizuar me lëkurë të butë me trashësi rreth 0,8 mm e pozicionuar në pjesën e poshtme ku mbështetet thembra, poshtë së cilës është vendosur një shtresë sfungjeri amortizuese. Thembra bashkohet me gjysmë shtrojën nëpërmjet procesit të ngjitjes.

SHTROJA

Është e realizuar me material shumë shtresor të bashkuara ndërmjet tyre me ngjitës.

SHOLLA PREJ GOME

Është monoblok e realizuar prej materiali gome me takë të integruar dhe bashkohet me xhiron rrethuese, shtrojën, nëpërmjet procesit të ngjitjes. Sholla është prej gome dhe është e modeluar me vijëzime jo simetrike për të garantuar funksionin e mos rrëshqitjes.

Artikulli konsiderohet teknikisht i pranuar kur ai plotëson të gjitha kërkesat e këtij Specifikimi Teknik

Sasia: 40 (dyzetë) palë.

6-Corape Burrash

ÇORAPE PAMBUKU

Çorapet e pambukut janë të punuara me përbërje 60 % pambuk dhe 40% akrilik në ngjyrë blu të errët. Nga brenda çorapet të jenë tip peshqir, materiali përbërës i çorapeve nuk lejohet të ketë tonacione ngjyrash e defekte të tjera në pamjen e jashtme. Çdo palë çorape të jetë e pajisur me një etiketë ku të ketë të shënuar përbërjen dhe numrin e këmbës.

Corapet e burrave duhet te jene te certifikuara sipas standardit nderkombetar OKEOTEX Standard 100

Artikulli konsiderohet teknikisht i pranuar kur ai plotëson të gjitha kërkesat e këtij Specifikimi Teknik.

Sasia: 200 (dyqind)Palë



SET I VESHJEVE VERORE PER SHERBIMIN MZSH TË A.P.D.

7- Xhakete + 2 Pantallona + 1 Kapele verore

Kostum pune vere, materiali duhet të jetë dok, ngjyra blu e errët, e qepur me blu e cila përmban (xhakete, pantallona dhe kapele).

XHAKETA

Materialet ndihmëse që duhet të përdoren për prodhimin e artikullit “Xhakete” janë:

- Dok trikoton;
- Penj qepje, blu e errët me ngjyrën e dokut;
- Velkrofe “femër” me ngjyrë blu të errët.

Artikulli xhakete “Kostum pune vere” prodhohet në bazë të gjatësive trupore dhe porositet nga përdoruesi në sasi të përkatëse sipas numrave të gjokseve, të cilat subjekti prodhues është i detyruar t’i respektojë saktësisht.

Përmasat e duhura të elementeve, të cilat bëjnë pjesë në ndërtimin e artikullit “Kostum pune vere”, janë:

- Xhaketa përbëhet nga jaka, shpina, mëngët, gjokset, dorezat e mëngëve, bordura përpara, xhepat e poshtëm anash, sipër në gjoksin e majtë vendoset velkrof “femër” në formë drejtkëndëshi me ngjyrë të zezë, bordura e poshtme dhe astari i brendshëm, shirita fosforeshente te krahu i majtë e i djathtë, shirit fosforeshent te gjoksi sipër dhe shiriti fosforeshent është te pjesa fundore e xhupit.

- Gjoksi i majtë dhe i djathtë përpara ka një shirit fosforeshent në ngjyrë gri metalizato me përmasa 6 cm të gjerë, të cilës në të dy anët gjatë gjithë gjatësisë i kalohen tegelat e zbukurimit 5 mm larg buzëve. Në anën e majtë të kraharorit vendoset xhepi i kraharorit për radio 15x3 cm. Sipër xhepit të radios vendoset velkrof në ngjyrë blu për vendosjen e shenjës së emrit.

-Shpina mbrapa në pjesën e sipërme do të vendoset një shirit me përmasa në lartësi 15 cm, dhe gjerësi sa ajo ndërmjet gavaturave. Ngjyra e shiritit do të jetë gri metalizato, mbi të cilën do të shkruhet me shkronja shtypi “ZJARRFIKËS”. Shkrimi do të jetë ngjyrë blu e errët.

PANTALLONA VERE

Pantallona vere, dok me ngjyrë blu të errët.

I. KONSTRUKTIMI I PANTALLONAVE VERORE

Pantallonat përbëhen nga këto elementë:

- qemeri;
- këmbët;
- xhepa oblig (klasikë), të pjerrët përpara;
- xhepa fileto në pjesën e pasme.

Qemeri	Qemeri duhet të jetë realizuar me tekstil dopio dhe i përforcuar në brendësi me anë të frazulinës me termofiksim për qëndrimin e formës; Hapja dhe mbyllja e qemerit realizohet me anë të kopsës plastike me ngjyrë të zezë dhe vrimës së aplikuar në të dy skajet e tij; Në qemer janë aplikuar 6 ylyqe (kalues) të realizuara me dopio tekstil.
Këmbët	Pantallonat janë realizuar më këmbët në pjesët përpara dhe pas, të cilat bashkohen me njëri-tjetrin me anë të tegelave anësorë dhe tegelave nga brenda këmbëve; Pjesët përpara janë realizuar me penca; Hapja dhe mbyllja e pantallonave realizohet me anë të kopsave të montuara në sallki, në varësi të masës; Linja fundore e këmbëve përfundon me kthim pale me lartësi rreth 2.5–3 cm.
Xhepat e pjerrët, përpara	Në secilën këmbë përpara nën linjën e qemerit janë aplikuar xhepat klasikë të pjerrët.
Xhep fileto pas	Xhepi fileto pas, duhet të jetë me kapak; Kapaku është realizuar me tekstil dopijo dhe përbëhet nga pjesa e sipërme dhe e poshtme; Në distancë rreth 1 mm larg buzës i kalohet një tegel zbukurimi; Hapja–mbyllja e xhepit me kapakun realizohet me kopsën në ngjyrë të zezë dhe vrimën.
Astari	Është aplikuar në xhepat e pantallonave para dhe pas.

KAPELA

- Kapela duhet te jetë dok, blu e errët, e qepur me pe blu të errët;
- Materialet ndihmëse që duhen të përdoren për prodhimin e artikullit “kapelë” janë:
- dok, blu e errët;
- penj qepje, me ngjyrën e dokut;

Artikulli konsiderohet teknikisht i pranuar kur ai plotëson të gjitha kërkesat e këtij Specifikimi Teknik.
Sasia:40(dyzet)cope

8-BLUZA ME MËNGË TË SHKURTRA

- Bluza me mëngë të shkurtra është me ngjyrë blu të errët, me mëngë të shkurtra dhe e përbërë prej materialit 100 % të pambukut.
- Në pjesën e përparme në anë të majtë në lartësinë e gjoksit është qepur logo me shkronjat kapitale “MZSH”.



BLUZË ME MËNGË TË SHKURTRA

Bluza me mëngë të shkurtra është e realizuar me tekstil trikotazh, 100% pambuk me ngjyrë blu.

I. NDËRTIMI I BLUZË ME MËNGË TË SHKURTRA.

Bluza përbëhet nga jaka klasike me mëngë të shkurtra.

- Përpara;
- Shpina;
- Mëngë të shkurtra.

Jaka	Jaka është model klasik i realizuar me tekstil prej trikotazhi llastik në drejtim vertikal me lartësi standarde (fikse) prej 7 cm.
Përpara	Përpara polo është ndërtuar vetëm nga një pjesë dhe përgjatë linjës qendrore në korrespondencë me hapjen e jakës paraqet një hapje me thellësi rreth 13.5 cm; Në anën e majtë të veshur në hapje (të quajtur dhe fileto) janë aplikuar dy vrima, një vrimë në drejtim horizontal, në distancë rreth 1 cm nga bordura e sipërme, dhe një vrimë në drejtim vertikal, në distancë rreth 6,5 cm nga vrima e parë; Ana e djathtë është e përbërë nga dy shtresa tekstili të qepura ndërmjet tyre ku në brendësi të tyre është aplikuar një shtresë tekstili termoadezive e pa deformueshme (frazelinë) e cila shërben si fortesë, në linjën qendrore përgjatë aksit të kësaj ane janë montuar dy kopsa të qepura me fill qepës prej poliesteri me katër vrima në korrespondencë me vrimat e aplikuara të anës tjetër.
Shpina	Shpina është realizuar me një pjesë; Linja fundore e polos si në pjesën përpara ashtu dhe në pjesën pas, përfundon me një kthim bordure rreth 2 cm.
Mëngë të shkurtra	Mëngët duhet të jenë të gjata me një pjesë në formë turbolare. Mëngët mbyllen me qepje të poshtme me tegel linear njëgjilpërësh dhe të rforcuar nga brenda me tegel syzator. Mëngët përfundojnë me një bordurë prej tekstili trikotazh llastik me gjerësi rreth 3 cm.

Velkrof	Në gjoksin e anës së djathtë montohet velkrof “femër” në ngjyrë blu të errët, për fiksimin e stemës me shkronja kapitale “MZSH”; Në krahun e majtë dhe në të djathtë të veshur, në këmishë vendosen velkrofet “femër” në ngjyrë blu të errët.
---------	--

MATERIALET NDIHMËSE QË DUHET TË PËRDOREN PËR PRODHIMIN E ARTIKULLIT “POLO - BLUZË ME MËNGË TË SHKURTRA”:

- Tekstil trikotazh, 100% pambuk, me ngjyrë blu të errët;
- Fill qepës 100% poliester me ngjyrën e pambukut;
- Velkrofe “femër” me ngjyrë blu të errët.

Artikulli konsiderohet teknikisht i pranuar kur ai plotëson të gjitha kërkesat e këtij Specifikimi Teknik.

Sasia: 160(njeqind e gjashte dhjetë) copë

9-KËPUCË VERORE .

Këpucët janë prodhuar me material lëkure rezistente në lagështi me trashësi prej 1,8–2,0 mm dhe material gome.

Këpucët përbehen nga këto elemente:

- faqe këpuce;
- maja;
- përforcues i brendshëm;
- astar i brendshëm;
- thembra;
- shtroja (mbështetësja);
- shollë gome TR.



FAQE KËPUCE

Faqet e këpucës janë realizuar me pjesë të cilat bashkohen ndërmjet tyre me anë të tegelit qepës. Lëkura e përdorur duhet të jetë e një cilësie të mirë, e marrë nga pjesët më të mira, e trajtuar me krom, me ngjyrë të zeze me trashësi rreth 1,8–2 mm. Faqet kambale janë përshkuar si nga tegela bashkues qepës perimetral, ashtu dhe me tegela për efekt estetik. Në dy faqet kambale, në lartësinë e qafës së këpucës, janë aplikuar katër vrima me veshje hekuri të cilat shërbejnë për mbylljen e këpucës nëpërmjet lidhëseve tubolare prej pambuku. Faqja e përparme bashkohet me trupin e faqeve me tegel qepës zbukurues dhe përfundon në afërsi të qafës së këpucës me aplikimin e një llape e cila është e përforcuar me anë të tegelit qepës syzator dhe montuar me anë të tegelit qepës perimetral.

Faqet bashkohen me shtrojën, xhiron rrethuese dhe shollën nëpërmjet procesit të ngjitjes.

MAJA

Është realizuar nga material prej pambuku të presuar me ngjitës me bazë laktike, me trashësi rreth 0,8 mm, aplikuar në pjesën e përparme nga brenda këpucës ndërmjet astarit dhe faqes së sipërme të këpucës.

PËRFORCUES I BRENDSHËM

I realizuar prej materiali sintetik në brendësi dhe në anën e pasme ndërmjet faqes së sipërme dhe astarit të brendshëm.

ASTARI I BRENDSHËM

Pjesa e brendshme e këpucës: llapa, faqet kambale dhe thembra janë realizuar me astar prej lëkure të butë.

THEMBRA

Është realizuar me material lëkurë me trashësi rreth 2 mm, e pozicionuar në pjesën mbështetëse të thembrës, në pjesën e poshtme të së cilës është aplikuar një shtresë sfungjeri amortizuese. Thembra bashkohet me shtrojën me anë të procesit të ngjitjes.

SHTROJA

Është e realizuar me material shumë shtresor me anë të procesit të ngjitjes dhe është e përbërë nga:

- texon (karton kompakt);
- lamin;
- kambrion (karton i presuar);
- taban prej lëkure;
- gjysmë shtroje prej lëkure derri e trajtuar me krom.

SHOLLA PREJ GOME

Është realizuar me material gome, dhe bashkohet me tabanin nëpërmjet ngjitjes. Pjesa fundore e këpucës përfundon me një dizejmim me vijëzime me dimensione të ndryshme për funksion anti rrëshqitës.

AKSESORËT

Filli – për faqet e këpucës përdoret fill qepës me përbërje 100% poliamid;

Thumbat – prej hekuri të përdorur për montimin e thembrës;

Ngjitësit – duhet të jenë të llojit dhe të cilësisë nga më të mirët në treg, jo dëmtues dhe të përshtatshëm në përdorim;

Lidhëset – duhet të jenë prej pambuku të mercerizuar të tipit tub me ngjyrë të zezë, që nuk krijojnë nyje me ekstremet plastike.

Artikulli konsiderohet teknikisht i pranuar kur ai plotëson të gjitha kërkesat e këtij Specifikimi Teknik.

Sasia:40(dyzet)Palë

III – LOGOT E SHËRBIMIT “MZSH”

10-LOGO MBIEMRIT: vendoset në pjesën e majtë të përparme të uniformës.



Specifikimi Teknik i artikullit “Logo e MZSH-Mbiemri” për Forcat e Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit të APD-se paraqet kërkesat themelore teknike të domosdoshme.

Të gjitha përcaktimet teknike të këtij Specifikimi Teknik duhen të zbatohen detyrimisht saktë nga prodhuesi.

Trëguesit fiziko-mekanik e kimik të lëndës së I-rë tekstil **fibrasintetike** si dhe të materialeve të tjera ndihmëse që do të përdorën për rkonfeksionimin e artikullit “Logo e mbiemrit” duhet të rezultojnë të jenë domosdosmërisht në përputhje me Specifikimet Teknike të mëposhtme. **Materialet** që duhet të përdorën për prodhimin e artikullit “Logo e mbiemrit” janë: **Lënda e I-rë tekstil me fibra sintetike** cilesia e I-rë me këto të dhëna:

- Përbërja **100 % fibra sintetike**
- Thurja **Trikotazhthurje bazë**
- Qendrueshmeria e ngjyrës **Nota 4 - 5**

Vlera e qendrueshmërisë së ngjyrës së lëndës **I-rë** tekstil **fibra sintetike** duhet të jetë e qendrueshme dhe shumë e qendrueshme. **Nota 4-5.** Nga ajo e dorëzuar në ofertë. (**Nota 4-5**)

PËRSHKRIM

Logo e mbiemrit me PVC dhe i stampuar mbiemri me serigrafi ne kohen e dorezimit te mallit sipas porositesit. Dimensionet e logos se mbiemrit jane: Gjatesia 7 cm dhe Gjeresia 2.5 cm. Logo e mbiemrit duhet te jete domosdoshmerisht e ngjitur me sistemin velkrof. Njera pjese e velkrofit(mashkull) ngjitet ne logo ndersa pjesa tjeter (femer) qepet ne anen e djathte te gjoksit dhe në:

- Xhup dimëror
- Xhup i holle
- Kostum shërbimi/Xhakëtë
- Pulovër dimri
- Bluze me minge te gjata
- Bluze pambuku me mëngë të shkurtëra

Amballazhimi, marketimi dhe etiketimi

Logot paktohen me nga 10 cope ne qese telefoni dhe paketimi I tyre behet ne kuti kartoni ne sasi qe pesha e tyre te mos shkaktoje deformim te kutise. Mbi kuti vendoset etiketa ku te jete shkruar qarte emir i firmes,numri,sasia dhe vula perkatese.

Artikulli konsiderohet teknikisht i pranuar kur ai ploteson te gjitha kerkesat e ketij Specifikimi Teknik.

Sasia: 80 (tetedhejte) cope

11-Logo në krahë për Forcat e Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit të APD-së. **STEMA E SHËRBIMIT “MZSH”:** Stema e shërbimit të MZSH-së, vendoset në krahun e majtë të uniformës



Specifikimet e stemës së MZSH-së: Paraqitet me një shqiponjë të zezë në pjesën e sipërme, hidrant në pjesën e djathtë, në qendër paraqet imazhin e flakës, simboli i shkallëve dhe sëpatës, në pjesën poshtë me shkronja kapitale “MZSH”, me ngjyrë të verdhë, në të majtë imazhin e shpëtimit.

- Ngjyra **Sipas fotos**
- Përbërja **100 % fibra sintetike**
- Thurja **Trikotazhthurje bazë**
- Qendrueshmeria e ngjyrës **Nota 4 - 5**

Vlera e qendrueshmërisë së ngjyrës së lëndës **I-rë** tekstil **fibra sintetike** duhet të jetë e qendrueshme dhe shumë e qendrueshme. **Nota 4-5.**

PËRSHKRIM

Logo në krahë për MZSH ka konfigurimin sipas fotos dhe me velkrof , me qendrisje **Dimensionet** e logos në krahë janë: Forma elips me diametra **11.2cmx 9cm**.Logo në krah duhet të jetë domosdoshmërisht e ngjitur me sistemin velkrof. Njëra pjesë e velkrofit (mashkull) ngjitet në logo ndërsa pjesa tjetër (femër) qepet në krahë të majtë të:

- Xhup dimëror
- Xhup veror
- Kostum/ Xhaketë dimërore
- Pulovër me zinxhir
- Pulovër vere
- Bluze me mëngë të gjata
- Bluze pambuku me mëngë të shkurtëra

Amballazhimi, marketimi dhe etiketimi

Logot paktohen me nga 10 cope ne qese telefoni dhe paketimi i tyre behet ne kuti kartoni ne sasi qe pesha e tyre te mos shkaktoje deformim te kutise. Mbi kuti vendoset etiketa ku te jete shkruar qarte emri i firmes,numri,sasia dhe vula perkatese.

Artikulli konsiderohet teknikisht i pranuar kur ai ploteson te gjitha kerkesat e ketij Specifikimi Teknik.

Sasia: 80 (tetedhejte) cope

12-LOGO NË KAPELE: Kjo stemë vendoset në pjesën ballore të kapelës.

Specifikimi Teknik i artikullit “**Logo e MZSH-Logo e kapeles**” për Forcat e Sherbimit zjarrfikes te APD paraqet kerkesat themelore teknike te domsdoshme .

Te gjitha percaktimet teknike te ketij Specifikimi Teknik duhen te zbatohen detyrimisht sakte nga prodhuesi.

Treguesit fiziko-mekanik e kimik te lendes se **I-re PVC** si dhe te materialeve te tjera ndihmese qe do te perdoren per konfeksionimin e artikullit “**Logo e kapeles**” duhet te rezultojne te jene domosdosmerisht ne perputhje me Specifikimet Teknike te meposhtme.

Materialet qe duhet te perdoren per prodhimin e artikullit “**Logo e kapeles**” jane:

Lenda e I-re me PVC.

PËRSHKRIM

Logo e kapeles ka konfigurimin sipas fotos dhe i stampuar me serigrafi.

Dimensionet e *logos ne kapele* jane: 6cmx6cm.

Ngjyra sipas figures.

Amballazhimi, marketimi dhe etiketimi

Logot paktohen me nga 10 cope ne qese telefoni dhe paketimi i tyre behet ne kuti kartoni ne sasi qe pesha e tyre te mos shkaktoje deformim te kutise. Mbi kuti vendoset etiketa ku te jete shkruar qarte emri i firmes,numri,sasia dhe vula perkatese.

Artikulli konsiderohet teknikisht i pranuar kur ai ploteson te gjitha kerkesat e ketij Specifikimi Teknik

Sasia: 80 (tetedhejte) cope

Shënim:

MASAT DHE SASIA E PRODHIMIT TË ARTIKUJVE VESHMBATHJE PËR MZSH.

Artikujt do të porositet dhe do të prodhohet në masat S – XXXL dhe në sasi të që do të rezultojnë pas matjeve të *Punonjësve të MZSH së Portit Durrës*.

Marrja e masave trupore.

Marrja e masave trupore të mëposhtme është e nevojshme për nxjerrjen e përmasave të çdo artikulli:

ARTIKUJT E VESHMBATHJES PËR NJËSINË E MENAXHIMIT TË AUTOMJETEVE

1-Xhupa pune

Pershkrimi fizik:

Xhup ngjyre e verdhe me 2 shirita fosforeshente horizontale 32-33cm larg njera tjetres dhe me 2 shirita fosforeshente vertikale mbi supe. 2 shirita fosforeshente shtese ne secilin krah 32±1 cm larg njera tjetres. Shiritat fosforeshente te jene me gjeresi 5cm. Me kapuc qe mbyllet me velkro tek jaka mbrapa dhe me kordon per mberthim kur hapet. Pjesa e perparme me mbyllje me zinxhir ngjyre te verdhe me hapje ne dy drejtime, qe mbulohet nga nje bordure 7cm e gjere qe mberthehet me 5 precina metalike te barazlanguara 16.5 cm nga njera tjetra. 2 xhepa te jashtem – nga nje ne secilen ane me kapake kuti me permasa 20.5 x 8.5-9 cm, Xhep i brendshem ne anen e majte me permasa 16x17cm me mbyllje me velkro. Menge te brendshme me cope thurje llastik me gjeresi 6cm. Astari i brendshem me ngjyre te verdhe qepur ne forme rombesh. Xhupi do te kete logon e APD te stampuar ne gjoksin e majte me permasa 8-10cm dhe ne shpine me permasa 22-25cm me boje blu.

Jaka ne pjesen e qafes e larte 15cm. Xhupi me material me shikueshmeri te larte (I verdhe).

Etiketa e xhupit duhet te permbaje: emrin e prodhuesit dhe adresen e tij, modelin, standartin ISO qe ofron, perberjen e materialit dhe instruksionet e perdorimit.

Parametrat teknike

Xhupi duhet te jete i certifikuar sipas Rregullores Europiane 2016/425 dhe te permbushe standartet e meposhtme: S.SH. EN ISO 13688:2013, S.SH. EN ISO 20471:2013+A1:2016 klasi3, S.SH. EN ISO 342:2017 0.303 (B) m2 K/W 3 WP

Copa e jashtme duhet te jete pelhure poliester Oxford WT-300D 3.1 me veshje PU.

Mbushja e brendshme te jete mbushje 100% polyester HT-S-001

Shiritat reflektues: material fosforeshent 8906, CSR-1303, D1001

Fija e qepjes dhe asemblimit copes se jashtme te jete material poliester Oxford ET-300D 3.1 me veshje PU + HT-S-001 YS –P190T

Materiali fluoreshent wT 300D , 3.1 Pelhure polyester oxford me PU riveshje Puliuretan/ nejlon ne shikueshmeri te larte ngjyre portokalli ose te verdhe.

Materiali I pjeses se jashtme te kontrastit te jete ET 300D, 3.1 Pelhure polyester oxford me PU riveshje Puliuretan/ nejlon me ngjyre blu te erret ose bojeqielli.

Materiali I pjese se brendshme te kontrastit te jete tafta YS-P190T.

Buzet e shiritave me polyester 100% te thurur me shirita te zinj JX-PK650 1x1, 650 gr/m2

Gjate testimit per certifikimin me standartin EN343 : 2003 + A1:2007 copa e jashtme poliester Oxford WT-300D 3.1 me veshje PU duhet te kete kaluar me sukses standartet e meposhtme

ISO 4674:2003 Rezistente kunder grisjes

EN 20811 klasi 3 Rezistenca e penetrimit te ujit

EN 20811 mbas larjes klasi 3 Rezistenca e penetrimit te ujit

ISO 1421- ISO 13934-1 Fuqia dhe zgjatja e tensilit

EN 20811 klasi 3 -Rezistenca e penetrimit te ujit

EN 20811- mbas gerryerjes- klasi 3 Rezistenca e penetrimit te ujit

ISO 5077 Dimesioni i qendrueshmerise

EN 31092 klasi 1Rezistenca e avullit te ujit

EN 20811 mbas karburanteve klasi 3 Rezistenca e penetrimit te ujit

EN 20811 mbas vajrave klasi 3 Rezistenca e penetrimit te ujit

Gjate testimit per certifikimin me standartin EN 343 : 2003 + A1:2007 Fija e qepjes poliester Oxford WT-300D 3.1 me veshje PU duhet te kete kaluar me sukses standartet EN ISO 13935-2 (per fortesine e fijos) dhe EN 20811 (per rezistencen ndaj ujit).

Gjate testimin per certifikimin me standartin EN 343 : 2003 + A1:2007 asemblimi poliester Oxford WT-300D 3.1 me veshje PU + mbushja HT-S-001 + tafta YS-P0190T duhet te kete kaluar me sukses standardin EN 31092 (rezistencen e djersitjes)

Gjate testimin per certifikimin me standartin EN ISO 13688:2013 secili nga materialet (si te listuara meposhte) e xhupit

Copa e jashtme poliester Oxford WT-300D 3.1 me veshje PU

Mbushja e brendshme 100% polyester HT-S-001

Materiali fluoreshent WT-300D qofte I verdhe apo portokalli

Materiali I pjeses se jashtme te kontrastit ËT 300D

Buzet e shiritave me polyester 100% te thurur me shirita te zinj JX-PK650 1x1, 650 gr/m2

Fija e qepjes dhe asemblimit copes se jashtme

Duhet te kete kaluar me sukses standardet EN 14362-1:2013, ISO 1413 (per matjen e pH) dhe ISO 5077 (per matjen e qendrueshmerise se dimensioneve).

Gjate testimin per certifikimin me standartin EN ISO 20471:2013+A1:2016 shiriti fosforeshent 8906 dhe aksesoret e tij CSR-1303 dhe D1001 duhet te kene kaluar me sukses standardet CIE54.2 (per performancen retro-reflektive).

Gjate testimin per certifikimin me standartin EN ISO 20471:2013+A1:2016

